

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master Profesional në Shkenca

Politike me profile “Sjellja dhe Strategjitë Politike”; “Politika


Publike”

Universiteti European i Tiranës

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

PhD. Dorian Jano

PhD. Ilir Kalemaj



Qershor/2018

Faqe 1 nga 74



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profile “Sjellja dhe Strategjitë Politike”; “Politika Publike”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës.
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit.
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr.74, Datë 21.01.2009 / Urdhër Nr.380, Datë 12.10.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 68, datë 14.02.2011
5	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në Shkenca Politike me profile “Sjellja dhe Strategjitë Politike”; “Politika Publike”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve për programin e studimit: 2013-2014 2014-2015 2015-2016 2016-2017 2017-2018	4 studentë 2 studentë 0 studentë 4 studentë 4 studentë

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profile “Sjellja dhe Strategjitë Politike”; “Politika Publike”

Universiteti Europian i Tiranës është licencuar si Shkollë e Lartë Universitare Jopublike me Vendimin Nr. 636 datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave dhe akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246 datë 24.07.2009 për Programet e Ciklit të Parë “Bachelor”, Urdhër Nr. 68 datë 14.02.2011 për Programet “Master i Shkencave” dhe “Master i Nivelit të Dytë”, dhe Urdhër Nr. 47, datë 05.02.2015 për Programet e Studimit të Ciklit të Tretë (studime të doktoratës). Institucioni është riakredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”, si dhe akreditimet periodike të programeve të studimit me Urdhër Nr. 159-162 datë 07.04.2016, Urdhër Nr. 183 datë 19.04.2016, Urdhër Nr. 209, datë 28.04.2016.

Programi i studimeve Master Profesional në Shkenca Politike me profile “Sjellja dhe Strategjitë Politike”; “Politika Publike” për ciklin e dytë të studimeve, subjekt i këtij vlerësimi, ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Edukimit. Ky program studimi është licencuar me VKM Nr.74, Datë 21.01.2009 “Për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, në shkollën e lartë universitare private ‘Universiteti Europian i Tiranës’” si program studimi Master i Nivelit të Parë (MNP) me kohëzgjatje 1 vit akademik dhe 60 ECTS; dhe është akredituar me Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr.133 datë 2010-12-21 dhe Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.68 datë 14.02.2011, si Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) për një afat gjashtë (6) vjeçar. Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 218 datë 23.05.2011 “Për Regjistrimin e Formave të Diplomave të Shkollës së Lartë Universitare Jopublike ‘Universiteti Europian i Tiranës’” dhe Urdhrit Nr.380 datë 12.10.2015 “Për Riregjistrimin e Formave të Diplomave “Bachelor”, “Master Profesional” dhe “Master i shkencave” të Universitetit Europian të Tiranës” ky program studimi është regjistruar si program studimi i ciklit të dytë “Master Profesional”, me kohë të plotë në “Shkenca Politike” me profile “Sjellja dhe Strategjitë Politike” dhe “Politika Publike”. Në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, (neni 75, pika 6) Senati Akademik i Universitetit Europian të Tiranës me Vendimin Nr.7, datë 14.09.2016, pika 1, ka vendosur që programet Master Profesional të ofrohen me 60 ECTS, me kohëzgjatje normale 1 (një) vit akademik. Ky vendim që ka hyrë në fuqi në vitin akademik 2016-2017.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: PhD Dorian Jano dhe PhD Ilir Kalemaj ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Me datë 14.06.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 20.06.2018 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe vendosën të mos i marrin në konsideratë ato. Draft-RVJ kthehet në Raport përfundimtar.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit dhe Plotësimi i tyre nga Institucioni

Për rekomandimin “a) Të forcohet roli i strukturave kontrolluese për rritjen e efektivitetit sidomos në fushën e kërkimit shkencor” institucioni:

- ka miratuar strategjinë e kërkimit shkencor (2017-2020) në funksion të rritjes së efikasitetit në fushën e kërkimit shkencor. “Drejtimi strategjik i kërkimit shkencor kryhet nga Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor, Metodologjinë, dhe Cilësinë në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Studimeve Doktorale si dhe Senatit Akademik të cilët monitorojnë dhe vlerësojnë ndërtimin e SKSH-së me një vizion afatmesëm dhe afatgjatë, mbikëqyrin zbatimin e saj dhe përditësojnë prioritetet e kërkimit shkencor”.
- Gjithashtu, në funksion të rritjes së efektivitetit në fushën e kërkimit shkencor është vendosur sistemi i granteve kërkimore, nga i cili stafi akademik përfiton përkundrejt përmbushjes së një sërë detyrimesh për kërkimin shkencor. Për vlerësimin e kërkimit shkencor përdoren Indikatorët e Matjes së Performancës Kërkimore – Shkencore’, një sistem i ndërtuar me qëllim matjen në mënyrë objektive të punës kërkimore dhe shkencore. Indikatorët kanë për qëllim ta orientojnë pedagogun në planifikimin dhe zbatimin e punës së tij vjetore si dhe në funksion të kualifikimit shkencor të tij.
- Botimi i dy revistave shkencore ‘Polis’ dhe ‘Economicus’, sikurse dhe organizimi i përvitshëm i konferencës shkencore ndërkombëtare ‘Ditët e Studimeve Shqiptare’, shërbejnë në funksion të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së kërkimit shkencor dhe botimeve shkencore, si dhe ndikojnë në përhapjen e rezultateve të kërkimit shkencor tek një audiencë përtej institucionit. Anëtarë të stafit akademik kanë fituar bursa kërkimi në universitete evropiane dhe institucioni ka qënë i suksesshëm në përfshirjen në projekte kërkimore të Komisionit Evropian (referuar dokumentit çmime ndërkombëtare për kërkimin shkencor 2015 – 2018).

Për rekomandimin b) Në departamente të krijohen grupet mësimore kërkimore si njësi bazë për të menaxhuar më mirë si mësimdhënien ashtu edhe aktivitetin kërkimor, institucioni ka:

- organizuar lëndët të cilat mbulojnë tematika të ngjashme në grup-lëndë dhe ka caktuar përgjegjës grup-lëndë (me propozim të Përgjegjësit të Departamentit dhe me emërim nga Dekani) i cili ka kompetencë dhe është përgjegjës për për konsultimin e lëndëve të përbashkëta brenda departamentit, për të garantuar cilësinë e programeve të lëndëve brenda ekspertizës së tij, si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe në atë metodologjik, si për të siguruar përditësimin e tyre me të rejat e shkencave përkatëse. Përgjegjësi i grup-lëndëve shqyrton dhe miraton programet e grup lëndëve përkatëse, detyrat e kursit dhe tezat e provimeve të tyre sikurse dhe bashkëpunon ngushtë me grupet e kërkimit në fushën specifike. Ai gjithashtu kontrollon përputhshmërinë e temave të diplomës me aksin kërkimor të pedagogut udhëheqës. Institucioni është përparësor të garantojë në çdo rast që përkatësia e pedagogut në një grup-lëndë, të përkojë edhe me përkatësinë e tij në grupin kërkimor të udhëhequr nga një prej profesorëve të grup-lëndës përkatëse. Grupet kërkimore udhëhiqen nga anëtarët e personelit akademik të kategorisë Profesor dhe përfshijnë lektorët dhe asistent lektorët, të cilët kanë kompetencë në të njëjtën fushë kërkimore. Pjesë e grupeve kërkimore janë doktorantët sikurse dhe studentët e ciklit të dytë të studimeve, në ato raste kur tema e tyre përkon me projektin kërkimor

Për rekomandimin c) Fakulteti/Departamentet të shohin me përparësi rritjen e shkallës së kualifikimit të personelit akademik, që të gjithë titullarët e lëndëve të kenë gradën shkencore doktor, institucioni:

- Ka siguruar që për këtë program studimi të gjithë titullarët e lëndëve të kenë tituj dhe grada shkencorë. Që prej vitit 2012, i gjithë personeli i angazhuar në këtë program studimi mban gradën doktor dhe/ose tituj akademik, përveç vitit 2017-2018 dhe 2013-2014 ku një pedagog ka qënë në proces doktorature;
- Gjithashtu mbështet kualifikimin e pedagogëve për të ndjekur studimet e doktoratës në UET, ose në institucione jashtë vendit, duke akorduar periudha disa mujore kërkimi shkencor të paguar;
- ka zhvilluar politika mbështetëse për kualifikimin e mëtejshëm të personelit, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, publikimin e punës së tyre kërkimore, dhe mbështetje financiare në formën e granteve kërkimore. Gjithashtu pedagogët që kanë 5 vite punë në UET, gëzojnë të drejtën të përfitojnë semestrin sabbatik të paguar, megjithatë asnjë nga personeli akademik i programit të studimit nuk e kishte aplikuar.

Për rekomandimin d) Institucioni të punojë për punësimin me kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësimin me kohë të plotë, institucioni:

- e ka të përcaktuar në kontratën e punës, që personeli akademik i brendshëm nuk mund të punësohet me kohë të plotë në një institucion tjetër. Deklarimi i marrëdhënieve të tjera të punës është pjesë e kontratës individuale të punës. Që në momentin e nënshkrimit të kontratës, Punëmarrësi është i detyruar të vërë në dijeni Punëdhënësin mbi marrëdhënie të tjera pune me punëdhënësin të tjerë ose mungesën e marrëdhënieve të tjera të punës. Nëse marrëdhëniet e punës fillojnë pas lidhjes së kontratës, Punëmarrësi ka detyrim të deklarojë angazhimin dhe të kërkojë miratimin e Administratorit.
- ka siguruar që për vitin 2013-2017 programi i studimit të mbulohet në masën mbi 70% nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë pranë UET. Të dhëna Tabela 3 Aneks: 2012-2013 (66%), 2013-2014 (71%), 2014-2015 (88%), 2015-2016 (78%), 2016-2017 (78%), 2017-2018 (83%).

Për rekomandimin e) Të aktivizohen më shumë ekspertë, edhe me statusin e "guest speaker", për të realizuar më mirë shkëmbimin e përvojave edhe me universitetet e tjera por edhe me ekonominë, institucioni:

- ka institucionalizuar angazhimin e lektorëve të ftuar dhe ekspertëve të fushave të ndryshme për të mbuluar tema në lëndë të caktuara. Ekspertët e ftuar janë emra të spikatur në fushën ekonomike, juridike, politike dhe sociale.
- Gjithashtu ka patur edhe lektorë të huaj të ftuar në kuadër të programeve të shkëmbimit

Për rekomandimin f) Në të gjitha programet të mos lejohet dhënia nga një titullar e më shumë se dy lëndëve, institucioni:

- ka qënë i angazhuar për një shpërndarje të ngarkesës mësimore të stafit akademik, dhe numri i pedagogëve të angazhuar në programin e studimit ka qënë i mirë, asnjë titullar nuk jep më shumë se 2 lëndë dhe në disa raste janë dy pedagogë që mbulojnë një lëndë të caktuar në mënyrë që të përshtatet natyra e kualifikimit të tyre akademik me natyrën e lëndës në fjalë.

Për rekomandimin g) Të behet i detyrueshëm disponimi i materiali bazë (leksione të shkruara) në shqip, institucioni:

- ndjek politika të mbështetjes së stafit akademik për përkthimin e teksteve kryesore për lëndët në të cilat ata janë të angazhuar. Për secilën lëndë përgatitet material i shkruar në gjuhën shqipe, kryesisht në formën e prezantimeve në PowerPoint. Në literaturën e rekomanduar, përcaktohen tekste në gjuhën shqipe, të cilat duhet të jenë sa më afër me tematikat e trajtuara në lëndën përkatëse;

Për rekomandimin h) Të normohet numri i faqeve të leksioneve të shkruara në rreth 10-15 faqe për leksion, institucioni:

- ka unifikuar formatin e silabuseve të cilat kanë mirëpërcaktuar literaturën bazë të detyrueshme me vendosjen e një kapitulli ose leksione të pedagogut ku përcaktohet edhe numri i faqeve për çdo temë leksioni.

Për rekomandimin i) Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si p.sh., te programi “MNP Shkenca Komunikimi”, “MND Marrëdhënie Ndërkombëtare”, etj., institucioni:

- pas akreditimit të parë të programeve, ka ngritur grupe pune të cilët kanë pasur si detyrë rishikimin e programeve në tërësinë e tyre, me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës dhe standardet e cilësisë, sikurse dhe me praktikën dhe modelet bashkëkohore të ndjekura nga universitetet perëndimore. Pjesë e këtij procesi, përveç anëtarëve të stafit akademik kanë qenë dhe studentët sikurse dhe ekspertët të jashtëm. Ky proces është finalizuar me rishikimin e plani mësimor i cili ka ndryshuar në 3 lëndë. Konkretisht, Lënda 1 Konceptim dhe menaxhim fushatash ishte lëndë e detyrueshme për profilin Sjellja dhe Strategjitë Politike kaloi lëndë e detyrueshme në kategorinë B për të dyja profilet, në profil kjo lëndë u zëvendësua me lëndën Lëvizjet e reja politike. Lënda 2 Menaxhim dhe Vleresim Projektesh ishte lëndë opsionale në kategorinë C kaloi lëndë e detyrueshme në kategorinë B. Lënda 2 Praktika profesionale ishte me 8 kredite ECTS u bë me 10 kredite ECTS.

Për rekomandimin j) Kurikulat të përcaktojnë më qartë dhe më thjeshtë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar, institucioni:

- ka unifikuar formatin e silabuseve të cilat kanë mirëpërcaktuar literaturën bazë të detyrueshme për çdo temë duke vendosur një kapitull ose leksione të pedagogut ku përcaktohet qartë edhe numri i faqeve. Ndërkohë që literatura shtesë është e rekomanduar për çdo temë leksioni.
- Ka parashikuar në dokumentin mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës që literatura për çdo lëndë në ciklin e dytë të studimeve duhet të mbështetet në 2-3 tekste bazë dhe 10-15 materiale si literaturë e rekomanduar ku përcaktohet edhe numri i faqeve për çdo temë leksioni.

Për rekomandimin k) Të shikohet mundësia e ngarkesave në planet mësimore për ta bërë më intensiv procesin e angazhimit të studentit (diferencime në numrin e krediteve për lëndë të veçanta), institucioni:

- Aplikon mënyra të zhvillimit të mësimin të përshtatshme për të garantuar mundësinë e angazhimit të vazhdueshëm të studentëve dhe zhvillimi i orëve ndërthurin shpjegimet teoriko-aplikative duke u fokusuar tek ndërveprimi i vazhdueshëm pedagog – student, dhe garanton zhvillimin intensiv të procesit të angazhimit të studentëve. Diskutimet, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet janë disa nga instrumentet kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve.
- Megjithatë, nisur nga fakti që ky program studimi tashmë ofrohet me vetëm 60 ECTS, lë pak hapësirë për diferencim në numrin e krediteve për lëndë të veçanta të cilat përbëjnë profilizimin, përveçse rastit të diferencimit të numrit të orëve për çdo lëndë e cila aktualisht ka të njëjtën ngarkesë (6ECTS).

Për rekomandimin l) Të harmonizohet më mirë shpërndarja e mësimdhënies në kohë gjatë javës, institucioni:

- Zhvillimi i mësimin për programet e ciklit të dytë realizohet nga e merkura në të premte 17.00 – 20.00 dhe të shtunave 9.00 – 17.00. Duke qenë se një pjesë e studentëve janë në marrëdhënie pune, preferohet zhvillimi i mësimin pasdite, megjithatë dita e shtunë është e mbingarkuar prandaj rekomandohet shpërndarja më e mirë e ngarkesës edhe në ditët e tjera të javës.

Për rekomandimin m) Të vazhdohet puna e nisur me Universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht, të shtohen kontaktet me universitetet e tjera, institucioni:

- UET ka bashkëpunimi me institucione të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, sektorit publik dhe atij privat me qëllim krijimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët si edhe stafin akademik. UET është pjesë e Rrjeteve Ndërkombëtare të Universiteteve si SEUN Spanjë; UNIMED Itali; FEDE Portugali. Pjesë e projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si Erasmus+ KA1 dhe KA2 të Komisionit Europian; të projekteve kërkimore dhe rrjetëzimit si COST dhe Horizon2020 të Komisionit Europian; Visegrad

University Fund. Aktualisht UET ka bashkëpunime me rreth 100 universitete të huaja dhe 15 universitete në vend.

Për rekomandimin n) Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë modeli perëndimor në plotësimin e përmirësimit e planeve mësimore, institucioni:

- Gjatë këtyre viteve UET ka pasur bashkëpunime me Universitete të ndryshme perëndimore, e cila vlerësohet pozitive në përmisimin e planeve mësimore dhe sillabuseve. Mobiliteti dhe angazhimi i pedagogëve në projekte akademike evropiane ndihmon në këtë aspekt.

Për rekomandimin o) Të përmirësohet bashkëpunimi me universitetet në vend, për të thithur kontingjente të interesuara për ciklin e studimeve DND, MNP e MND në UET, duke eksponuar më mirë kriteret e pranimit, institucioni:

- Institucioni ka përcaktuar në objektivat e tij strategjik zgjerimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit me universitete vendase dhe të huaja. Ky bashkëpunim është formalizuar nëpërmjet një sërë aktivitetesh dhe projektesh të përbashkëta, si me universitete nga sektori publik ashtu edhe nga ai jo-publik. Në funksion të ekspozimit të kriterëve të pranimit në ciklin e dytë të studimeve, institucioni ka zhvilluar fushata informuese nëpërmjet mediave tradicionale dhe atyre sociale, informacioneve në faqen zyrtarë të UET, nëpërmjet organizimit të *Open Days* sikurse dhe informimit në ambientet e institucionit nga ana e këshilluesve të karrierës. Megjithatë konstatohet se numri i studentëve të interesuar për programin specifik është i ulët, dhe në disa vite nuk ka patur studentë të regjistruar për të ndjekur programin e studimit, dhe për të aktivizuar profilet.

Për rekomandimin p) Të rriten e forcohen kontaktet me punëdhënësit brenda e jashtë vendit për të rritur sigurinë e punësimit të studentët, institucioni:

- Për të forcuar bashkëpunimin me tregun e punës UET ka ngritur disa struktura dhe procedura, të cilat krijojnë disa hapësirave për punësimin e studentëve gjatë studimeve ose pas diplomimit (shoqata UET Alumni, "Forumi Universitet-Biznes", Projekti 250+, Panairi i përvitshëm i Punës, Bordet e tregut të punës). UET njëkohësisht ka ndjekur politika favorizuese të punësimit të studentëve brenda institucionit.

Për rekomandimin q) Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase dhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze, për studentët e diplomave DND, MNP e MND, institucioni:

- Për sa i përket kriterit të njohjes së gjuhës së huaj, kjo çështje është rregulluar nga legjislacioni për arsimin e lartë në fuqi.
- Ndërsa lidhur me aplikimin e mesatares, institucioni e aplikon atë në rastet kur aplikimet janë më të larta se kuotat duke përzgjedhur kandidatët të cilët kanë mesataren më të lartë. Megjithatë, nisur edhe nga fakti që ku program nuk ka numër të madh interesimesh ky kriter nuk aplikohet de fakto.

Për rekomandimin r) Të shihet mundësia e uljes së tarifës të studimeve duke vendosur raporte më eficiente në shpenzimet psh., reklamata publicitare, për të rritur më tej interesimin e kontigjenteve më cilësore, institucioni:

- Institucioni ndjek politika të mbështetjes financiare për kategori të ndryshme të studentëve, nëpërmjet reduktimit të tarifave, dhënies së bursave të plota dhe të gjysmë bursave. Kategoritë kryesore të përfituesve të mbështetjes financiare janë studentët që vijnë nga e njëjta familje, studentët e familjeve në nevojë, studentët e ekselencës dhe studentët e talentuar.
- Kosto e studimit për student viti akademik 2016-2017 ka qënë 182.500 lek (nr i studentëve 4066), ndërkohë që kosto për student në vitet paraardhëse (2014-2015, 2015-2016) ka qënë më e ulët (175.980, 165.100 respektivisht), sidomos kur numri i studentëve ka qënë më i madh (viti 2015-2016 4.149 studentë) kjo pasi burimi kryesor i financimit janë tarifatat për dhe gjatë shkollimit.

Për rekomandimin s) Të rriten të ardhurat nga aktiviteti kërkimor, duke u angazhuar në tematika që kanë interes për ekonominë e vendit tonë, institucioni:

- Nga takimet në institucion dhe të dhënat e përfuara na rezultojnë se nga viti 2013 institucioni ka arritur të përfitojë të ardhurat nga grantet për kërkim në nivelin 2-3% të totalit të burimeve financiare.
- Institucioni mbështet zhvillimin dhe financimin e projekteve kërkimore shkencore të anëtarëve të personelit akademik, si edhe inkurajon angazhimin e tyre në projekte. Zyra e Projekteve siguron, mbështet dhe koordinon aktivitetet e lidhura me projektet e kërkimit shkencor, si projektet kërkimore individuale të konceptohen në dobi të institucionit, shoqërisë dhe sektorit përkatës, ku pedagogu përfshin grupin e tij kërkimor, të përbërë nga asistentët ose kolegë të tjerë të fushave të përafërta; projektet me UET dhe partnerët, të cilat zakonisht janë të financuara nga të tretët, e në disa raste bashkë financohen nga UET; ekspertiza për të tretët, projekte të tjera jashtë UET, për të vënë në shërbim të sektorit publik ose privat ekspertizën e tij profesionale

Për rekomandimin t) Të synohet botimi i monografive me interes për institucione kërkimore shkencore brenda e jashtë vendit, institucioni:

- Institucioni inkurajon botimet kombëtare dhe ndërkombëtare të personelit akademik, si edhe pjesëmarrjen e tyre si referues në konferenca shkencore. Kjo mbështetje ofrohet si nëpërmjet grantit kërkimor ashtu edhe nëpërmjet faciliteteve të ofruara nga shtëpia botuese UET Press. Botimet shkencore të personelit akademik janë pjesë e vlerësimit nëpërmjet Indikatorëve të matjes së performancës kërkimore – shkencore.

Për rekomandimin u) Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, institucioni:

- Institucioni ndjek politika të mbështetjes dhe nxitjes së përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor. Kjo mbështetje realizohet nëpërmjet udhëheqjes së punimeve të diplomës të cilat bazohen në parimet, metodologjinë dhe instrumentet bashkëkohore të kërkimit shkencor; ose/dhe përfshirjes së studentëve në projektet ku UET është partner; ose/dhe mobilitetit të studentëve në kuadër të programeve Erasmus+.

Për rekomandimin v) Të pasurohet më tej fondi i bibliotekës edhe me literaturë të huaj dhe literaturë në shqip, kryesisht në funksion të plotësimit të nevojave të kurrikulave, institucioni:

- Biblioteka e UET disponon literaturën që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Sigurisht që pasurimi i saj është një përpjekje dhe objektivi i vazhdueshëm i institucionit, duke marrë parasysh dinamikën e publikimeve brenda dhe jashtë vendit. Për realizimin e programeve biblioteka zotëron gjithsej 6005 tituj të disponueshëm për studentët, nga këto në shqip janë 4634 tituj dhe në gjuhë të huaj 1371. Gjithashtu janë kryer abonime në biblioteka virtuale, dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë, ku rendisim: Sage, Ebsco (abonim 5-vjeçar) dhe Questia.

Rekomandimet	Shkalla e plotësimit të rekomandimit
a) Të forcohet roli i strukturave kontrolluese për rritjen e efektivitetit sidomos në fushën e kërkimit shkencor institucioni:	Plotësisht
b) Në departamente të krijohen grupet mësimore kërkimore si njësi bazë për të menaxhuar më mirë si mësimdhënien ashtu edhe aktivitetin kërkimor, institucioni ka:	Plotësisht
c) Fakulteti/Departamentet të shohin me përparësi rritjen e shkallës së kualifikimit të personelit akademik, që të gjithë titullarët e lëndëve të kenë gradën shkencore doktor, institucioni:	Plotësisht
d) Institucioni të punojë për punësimin me kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësimin me kohë të plotë, institucioni:	Plotësisht

e)	Të aktivizohen më shumë ekspertë, edhe me statusin e "guest speaker", për të realizuar më mirë shkëmbimin e përvojave edhe me universitetet e tjera por edhe me ekonominë, institucioni:	Plotësisht
f)	Në të gjitha programet të mos lejohet dhënia nga një titullar e më shumë se dy lëndëve, institucioni:	Plotësisht
g)	Të behet i detyrueshëm disponomi i materiali bazë (leksione të shkruara) në shqip, institucioni:	Plotësisht
h)	Të normohet numri i faqeve të leksioneve të shkruara në rreth 10-15 faqe për leksion, institucioni:	Plotësisht
i)	Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si p.sh., te programi "MNP Shkenca Komunikimi", "MND Marrëdhënie Ndërkombëtare", etj., institucioni:	Plotësisht
j)	Kurikulat të përcaktojnë më qartë dhe më thjeshtë literaturën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar, institucioni:	Plotësisht
k)	Të shikohet mundësia e ngarkesave në planët mësimore për ta bërë më intensiv procesin e angazhimit të studentit (diferencime në numrin e krediteve për lëndë të veçanta), institucioni:	Kryesisht
l)	Të harmonizohet më mirë shpërndarja e mësimdhënies në kohë gjatë javës, institucioni:	Kryesisht
m)	Të vazhdohet puna e nisur me Universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht, të shtohen kontaktet me universitet e tjera, institucioni:	Plotësisht
n)	Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë modeli perëndimor në plotësimin e përmirësimin e planeve mësimore, institucioni	Plotësisht
o)	Të përmirësohet bashkëpunimi me universitetet në vend, për të thithur kontingjente të interesuara për ciklin e studimeve DND, MNP e MND në UET, duke ekspozuar më mirë kriteret e pranimit, institucion	Kryesisht
p)	Të rriten e forcohen kontaktet me punëdhënësit brenda e jashtë vendit për të rritur sigurinë e punësimit te studentët, institucioni	Plotësisht
q)	Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase dhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze, për studentët e diplomave DND, MNP e MND, institucioni:	Plotësisht
r)	Të shihet mundësia e uljes së tarifës të studimeve duke vendosur raporte më eficiente në shpenzimet psh., reklamat publicitare, për të rritur më tej interesimin e kontigjenteve më cilësore, institucioni:	Kryesisht
s)	Të rriten të ardhurat nga aktiviteti kërkimor, duke u angazhuar në tematika që kanë interes për ekonominë e vendit tonë, institucioni	Plotësisht
t)	Të synohet botimi i monografive me interes për institucione kërkimore shkencore brenda e jashtë vendit, institucioni	Plotësisht
u)	Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, institucioni	Plotësisht

v) Të pasurohet më tej fondi i bibliotekës edhe me literaturë të huaj dhe literaturë në shqip, kryesisht në funksion të plotësimit të nevojave të kurrikulave, institucioni	Plotësisht
---	------------

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Gjatë shqyrtimit paraprak të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe intervistave në terren, konstatojmë se qëllimet e objektivave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor janë në nivelet e kërkuara dhe të standartizuara sipas kërkesave të ligjit për arsimin e lartë dhe në përputhje me strategjinë e miratuar nga vetë institucioni.

Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profile ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit pranë Universitetit European të Tiranës, dhe bën pjesë në programet e ciklin e dytë të studimeve universitare duke e ofruar me kohëzgjatje 1/1.5 vite akademike dhe 60/90 ECTS respektivisht. Që prej vitit akademik 2016-2017 ky program studimi me vendim të Senati Akademik të UET ofrohet me një kohëzgjatje normale 1 vjeçare me 60 ECTS. Megjithatë ky ndryshim nuk është reflektuar në rregulloren mësimore të programit të studimit Master Profesional në Shkenca Politike, ku pika 3 parashikon ofrimin e programit të studimit me 60 ose 90 ECTS (Struktura e programit mësimor 3.1.2) dhe si kohëzgjatje normale të studimeve 1.5 vite (3.2 Kohëzgjatja e studimeve).

Masteri Profesional në Shkenca Politike me profile synon të përforcojë më tej përgatitjen e studentëve të cilët kanë kryer studimet dhe janë angazhuar në fushën e politikës ose të administrimit publik, duke theksuar lëndët me karakter praktik. Ky program studimi ofron njohuri specifike dhe të aplikuara të profesionit të politologut, ai ka natyrë aplikative dhe i orjenton studentët drejt objektivave profesionale sipas profileve përkatëse me qëllim kualifikimin dhe punësimin në një drejtim të specializuar. Profili Sjellja dhe Strategjitë Politike fokusohet në kuptimin dhe shpjegimin e marrëdhëies midis veprimit politik të qytetarëve dhe proceseve politike në një system demokratik duke u specializuar në sjelljen elektorale dhe politike, zgjedhjet dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, opinionin publik, komunikimin dhe lidhshimin politik si dhe aspektet të tjera të sjelljes dhe strategjive politike duke synuar t'i pajisë studentët me njohuri dhe aftësi profesionale të të kuptuarit dhe analizuarit të komunikimit, strategjive dhe rezultateve elektorale dhe politike. Profili Politikat Publike fokusohet në instrumentat dhe modelet e ndërveprimit të aktorëve politik (publik dhe privatë) gjatë procesit të formulimit dhe zbatimit të politikave publike në sektorë të ndryshëm duke u specializuar në analizën dhe advokimin e politikave publike si dhe në menaxhimin e programeve të ndryshme me ndikim të gjerë publik. Ky program studimi synon t'i pajisë studentët me njohuritë e nevojshme analitike dhe praktike për të qenë specialistë në fushën e politikave publike.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	
	<p>Programi i Studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profile është hartuar në përputhje dhe realizim të misionit dhe qëllimit të UET, për të ofruar programe studimi të orientuara kryesisht nga praktika profesionale dhe në përputhje me kërkesat e tregut. Gjithashtu, programi Master Profesional komplimenton objektivat e UET në fushën e edukimit dhe kërkimit për ciklin e dytë të studimeve në disiplinat e shkencave sociale, më specifikisht atë të shkencave politike.</p> <p>Nuk ka një studim të mirëfilltë për programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politike me të dhëna mbi nevojat e tregut dhe mundësitë e punësimit të studentëve. Gjithsesi, objektivat në aspektin e punësimit të studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit janë paraqitur në Aneksin e rregullores mësimore të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Politike” (Lista e profesioneve/ mundësive për punësim pas përfundimit të studimeve në shkenca politike). Gjithashtu, në vitin 2016 është kryer një studim me ish-studentët e programeve master shkencor dhe profesional (Studim Alumni 2010-2016), i cili është në nivel institucioni jo programi, dhe ka për qëllim të vlerësojë eksperiencën e studentëve gjatë dhe pas studimeve në mënyrë që të mund të përmirësohen programet dhe shërbimet për studentët. Gjithashtu, në nivel departamenti janë ngritur “Bordet e Tregur të Punës” me ekspertë dhe profesionistë të fushës me të cilët zhvillohen takime periodike për përshtatjen e programeve sa më afër kërkesave të tregut të punës.</p>
	<p>Programi i studimit është në shërbim të nevojave dhe prioriteteve të zhvillimit të vendit, duke i kushtuar vëmendje pocesive kryesore politike dhe demokratike.</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

	<p>Programi i përgjigjet nevojës kombëtare për nëpunës, konsulentë, dhe ekspertë të lartë në fushën e politikave publike dhe çështjeve politike.</p> <p>Programi i studimit pasqyron vullnetin e institucionit për të ruajtur disiplina si ajo e shkencave politike, dhe zhvilluar më tej ekspertizën në çështje të sjelljes politike dhe politikave publike. Programi i studimit është në përputhje me interesat dhe synimet strategjike të zhvillimit politik-ekonomik të vendit. Gjithashtu, në hartimin e këtij programi janë marrë në konsideratë zhvillimet politike të demokratizimit të vendit nëpërmjet trajtimit të tematikave dhe rasteve të studimit nga vendi, të cilat janë të përbrendësuar në shumicë e lëndëve të këtij programi dhe reflektojnë një qasje kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit dhe takimet me titullarët e institucionit, konstatojmë që programi i studimit është përshtatur dhe zhvilluar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit për të ofruar programe studimi të specializuara dhe në shërbim të profesionit me qëllim punësimin dhe integrimin në tregun e punës, ose zhvillimin e karrierës dhe kualifikimin në një drejtim të ngushtë.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit dhe takimet me titullarët e institucionit, konstatojmë se në hartimin e programit janë marrë parasysh kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profile është ri-organizuar disa herë për t'iu përshtatur ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë. Së fundmi, me vendimit e Senatit Akademik ky program i ciklit të dytë të studimeve ka një ngarkesë prej 60 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje normale studimi prej 1 viti akademik ose 2 semestrash. Veprimtaria mësimore dhe formuese e këtij programi studimi është organizuar në kategori të cilat përfshijnë veprimtari të formimit të përgjithshëm bazë, të formimit karakterizues, veprimtari në disiplina të ngjashme/integruese dhe në disiplina me zgjedhje, si dhe njohuri të tjera formuese të</p>

	<p>praktikës profesionale dhe punës kërkimore.</p> <p>Emërtimi, përmbajtja e programit dhe objektivat që synohet të arrihen në përfundim të tij janë në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve”, të përshtatshme për të mundësuar njohuri të specializuara dhe bashkëkohore, analiza kritike dhe qasje të reja, praktikë profesionale dhe kërkim shkencor në disiplinën e shkencave politike.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit dhe takimet me titullarët e institucionit, konstatohet se institucioni ka hartuar një plan strategjik në nivel institucional për Mësimdhënien dhe për Përvetësimin e Dijeve, si dhe ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2017 – 2020 ku përcaktohen drejtimet kryesore për zhvillimin e institucionit.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit (pika 10.2) parashikohet rishikimi periodik i programit të studimit (plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre). Ndryshimet për përmirësimin e programit mund të propozohen nga Departamenti, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, dhe pasi shqyrtohen në Departament dhe nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave i dërgohet për miratim Fakultetit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Konstatohet se programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profile “Sjellja dhe Strategjitë Politike”; “Politika Publike”:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Reflekton interesat dhe synimet strategjike të zhvillimit politiko-ekonomik të vendit dhe nevojën për ekspertë të lartë në fushën e shkencave politike; • është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për programet e studimit të ciklit të dytë, si dhe objektivat dhe përmbajtja e programit janë në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve”; • është hartuar në përputhje dhe realizim të misionit dhe strategjisë së zhvillimit të UET duke i materializuar objektivat strategjike të zhvillimit të institucionit për të ofruar programe studimi të specializuara dhe aplikative në shkencat politike’ si dhe operon sipas një plani strategjik në nivel institucional dhe rregullores së programit të studimit.² 	

² Rregullorja e Programit të studimit Master Profesional në Shkenca Politike, duhet të rishikohet pikën 3 (3.1.2 Struktura e programit mësimor; 3.2 Kohëzgjatja e studimeve) e cila parashikon kreditet e ofruara dhe kohëzgjatjen e këtij programi, për të reflektuar vendimin e Senatit Akademik të UET Nr.7 datë 14.09.2016, pika 1. Për ofrimin e

- mungon një studim i mirrëfilltë dhe konkret i tregut të punës për programin në fjalë mbi nevojat e tregut në nivel kombëtar apo rajonal, megjithatë institucioni ka realizuar një studim me ish-studentët për të vlerësuar programet e ciklit të dytë të studimeve, si dhe zhvillon takime periodike me bordet e tregut të punës.

Standardet janë plotësuar

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Universiteti European i Tiranës përbëhet nga 3 Fakultete: Fakulteti Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti Juridik, dhe Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit. Fakultetet janë njësi kryesore që bashkërendojnë mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore. Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Edukimit, e ri-organizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit të ri të arsimit të lartë, ai përbëhet nga 3 departamentet:

- Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara
- Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike
- Departamenti i Edukimit

Dekanati është organ drejtues kolegjal vendimmarrës, i cili drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga Zëvendësdekani, Administratori i Fakultetit, Përgjegjësi e Departamenteve, Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore-shkencore, Kryetarët e Komiteteve Shkencore të Programeve Master, Kryetari i Këshillit Studentor të Fakultetit si përfaqësues i studentëve.

Dekani është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Dekani koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore. Dekani është personel akademik i kategorisë "Profesor" dhe përzgjidhet mbi bazën e një procedure konkurrimi. Dekani emërohet nga Rektori për një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet, Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.

Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti më i lartë i njësisë bazë mësimore kërkimore. Përgjegjësi i Departamentit propozohet nga Senati Akademik dhe emërohet nga Administratori me një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi.

Përgjegjësi i grup-lëndëve është përgjegjës për konsultimin e lëndëve të përbashkëta brenda departamentit, për të garantuar cilësinë e programeve të lëndëve, brenda ekspertizës së tij, në përputhje me kriteret, standardet dhe procedural e UET, si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe në atë metodologjik. Shqyrton dhe miraton programet e grup lëndëve përkatëse, detyrat e kursit dhe tezat e provimeve të tyre. Përgjegjësi i grup-lëndëve propozohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe emërohet nga Rektori për një mandat maksimalisht 4 vjeçar.

Programi i Studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profile "Sjellja dhe Strategjitë Politike"; "Politika Publike" është program i ciklit të dytë të studimeve, pjesë e Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit përbëhet nga 3 departamente: Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara; Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike dhe Departamenti i Edukimit. Sipas të dhënave që morëm gjatë vizitës në Institucion, Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara ka aktualisht në përbërjen e tij për vitin akademik 2017-2018, **26 anëtarë** prej të cilëve, **21 janë Personel Akademik Efektiv (PAE)** dhe **5 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK)**. Personeli Administrativ (PA) është në funksion të të gjithë universitetit dhe përbëhet nga 52 anëtarë. Nga personeli akademik efektiv (PAE) 15 nga 21 (71%) janë me tituj dhe grada, ndërsa nga personeli akademik me kontratë (PAK) të gjithë (5) janë me tituj dhe grada (Shih Tabelën 1 në Aneks).

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Të dhëna për stafin e angazhuar në rang Fakulteti/Departamenti për vitin akademik 2016-2017, 2017-2018

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënljore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimi me titullarë të institucionit konstatojmë se struktura organizative e UET i përgjigjet objektivave të përcaktuara në misionin e institucionit dhe është në përmbushje të kërkesave të legjislacionit në fuqi.</p> <p>UET është i organizuar në 3 Fakultete (Fakulteti Ekonomik dhe IT, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, dhe Fakulteti Juridik).</p> <p>Fakulteti Ekonomik dhe IT, si dhe Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit janë të organizuara në 3 Departamente, si njësi bazë, ndërsa Fakulteti Juridik ka 2 Departamente dhe 1 Qendër Kërkimore si njësi bazë.</p> <p>Objektivat dhe misioni i njësisë bazë është përcaktuar në Statutin e UET (Neni 15). Qendra kërkimore-shkencore është njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi. Departamenti, si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.</p> <p>Personeli akademik i Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara që është</p>

përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në "Shkenca Politike" me profile, ka në përbërjen e tij 26 anëtarë të personelit akademik prej të cilëve 21 (80%) janë Personel Akademik Efektiv (PAE), nga të cilët 15 (71% e PAE) janë me tituj dhe grada; dhe 5 anëtarët e Personeli Akademik me Kontratë (PAK) janë me tituj dhe grada. Personeli Administrativ (PA) është në funksion të të gjithë universitetit dhe përbëhet nga 52 anëtarë.

Standardi II.3 - Njësiti e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Njësiti bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësiti bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për realizimin e programeve të studimeve përcaktohen në Statut dhe detajohen në rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit. Bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion nga Institucioni dhe takimit të realizuar me Dekanin e fakultetit dhe Shefin e Departamentit, konstatoam se Departamenti kishte këto funksionet kryesore: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve), si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve të përgjegjësve të grup-lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies.

Departamenti Përgjegjës për realizimin e programit të studimit zhvillon mbledhje një herë në javë, për të diskutuar në lidhje me çështjet dhe problematikat e ndryshme që dalin, për të garantuar mbarëvajtjen e zhvillimit të programeve të studimit.

Departamenti propozon profilin e nevojshëm të kandidatit për plotësimin e vendit vakant, në përputhje me ngarkesën mësimore që i nevojitet të plotësojë. Përgjegjësi i departamentit është anëtar i komisionit të rekrutimit të personelit të ri akademik. Gjithashtu, përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit gjatë vitit akademik, përfshi korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimin, dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike, si edhe cilësinë e mësimdhënies në auditor.

Konkluzionet e vlerësimit: Konstatohet se struktura organizative e UET i përgjigjet objektivave të përcaktuara në misionin e institucionit dhe është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu, Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara si njësi bazë e cila përgjigjet për zhvillimin dhe administrimin e programit të studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profile ndjek realizimin e programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyr cilësinë në mësimdhënies, si dhe është i përfshirë në

vlerësimin periodik të performancës dhe rekrutimin e personelit akademik.

Standardet janë plotësuar

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik dhe drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e IAL, këshillim për studentët, detyra administrative, në përputhje me detyrat e përcaktuara në statutin e Universitetit Europian të Tiranës dhe të rregulluara me Kontratën Individuale të Punës, e cila bazohet në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë. Mësimdhënia në këtë program studimi mbulohet nga Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) si dhe Personel Administrativ (PA). Mësimdhënia mbulohet nga 2 pedagogë të Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara, ndërsa pjesë tjetër e moduleve mbulohen nga pedagogë të Departamenteve të tjera, si ai i Menaxhim dhe Marketingut, ai i Komunikim dhe Marrëdhënieve publike, ai i Informatikë, Matematikë dhe Statistikë, si dhe një pedagog i jashtëm nga UKT.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit

Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara ofron gjashtë programe studimi të ciklit të parë Bachelor, dhjetë programe të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master Shkencor, si dhe një program të ciklit të tretë të studimeve Doktoraturë në Shkenca Sociale me profile.

Sipas të dhënave që morëm gjatë vizitës në institucion, në vitin akademik 2017-2018 për këtë program studimi aktualisht janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej **6 pedagogë të gjithë me tituj dhe grada (përveç një pedagogu i cili është në proces doktorature) dhe nga të cilët 5 (83%) janë personel akademik efektiv (PAE)**, duke mbuluar nevojat e raportit student-pedagogë dhe duke plotësuar kërkesat e IAL-së.

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat 3 në Aneks)

Indikatorët që lidhen me numrin e Personelit Akademik Efektiv dhe atë me Kontratë janë dykahësh. Nga njëra anë raporti PAE/PAK në këtë program studimi është përmirësuar ndër vite, ku në vitin akademik 2017-2018 është 5:1, nga të cilët 3 pedagogë janë nga departamente të tjera (Të dhënat për raportin PAE/PAK Viti 2012-2013 kanë qenë 4:2, Viti 2013-2014 5:2, Viti 2014-2015 7:1, Viti 2015-2016 7:2, Viti 2016-2017 7:2), ndërkohë konstatojmë uljen e numrit absolut të personelit akademik të angazhur në programin e studimit, për vitin akademik 2017-2018.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (Tabela 4 në Aneks)

Këshilli Shkencor i Programit të studimit ka tre anëtarë, (Me kryetar Përgjegjës e Departamentit dhe anëtarë përgjegjës e grup-lëndëve si dhe një anëtar të departamentit), dy me titullin Prof. Asoc dhe një anëtar me gradën Dr. Lëndët që mbulojnë pedagogët i përkasin kryesisht formimit të tyre duke gjykuar mbi profilin dhe tezat e tyre të doktoratave.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelën 3 në Aneks)

Që prej vitit 2012, i gjithë personeli i angazhuar në këtë program studimi mban gradën doktor dhe/ose tituj akademik, përveç vitit 2017-2018 dhe 2013-2014 ku një pedadog ka qënë në proces doktrature. Ka një raport të mirë midis personelit akademik me tituj dhe atyre me grada: 2017-2018, 1 prof. Asoc.Dr dhe 4 Dr/PhD; nga 2012 deri 2017 raporti i pedagogëve me tituj dhe atyre vetëm me grada shkencore ka qënë 50:50, 1 Prof.Dr. dhe 3 Prof. Asoc.Dr dhe 4 Dr/PhD. Gjithashtu duke gjykuar mbi profilin e pedagogëve, vlerësojmë se kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit është adekuat pasi lëndët që ata mbulojnë i përkasin kryesisht formimit dhe fushës së tyre të ekspertizës.

- Të dhënat sipas seksit

Në stafin aktual të personelit akademik për këtë program ka raporti burra : gra është për tu vlerësuar, 2 : 4 për vitin akademik 2017-2018, ndërkohë që edhe në vitet e mëparshme ky raport ka qënë në favor të pedadogeve gra.

- Të dhëna sipas moshës së personelit

PAE përbëhet nga disa grup moshë: 2 pedagogë në grupmoshën 25-35 vjec, 2 pedagogë në grupmoshën 36-45 vjec dhe 1 pedagog në grupmoshën 56-65 vjec dhe 2 në grupmoshën 66-68. Përbërja e stafit sipas moshës mundëson harmonizimin më të mirë të stafit me përvojë me stafin e ri dhe është një faktor i rëndësishëm për fuqizimin e njësisë. (Tabela 5 tek Aneksi)

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në Kontratën e lidhur me institucionin, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin, në Kodin e Etikës dhe në Kodin e Integritetit Akademik të miratuara nga organet drejtuese të universitetit. Nga dokumentacion që na u vu në dispozicion gjatë vizitës konstatuam se, anëtarët e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi kishtin kaluar në kontrata me afat të përcaktuar.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi administrativ është jo për çdo njësi bazë, por në nivel institucioni. Në total për vitin akademik 2017 – 2018 personeli administrativ i institucionit ka 52 anëtarë numër i cili është më i ulët se viti akademik parardhëse 2016-2017 me 68 anëtarë, por gjithsesi ka ardhur në rritje po të konsiderojmë anëtarët e personelit administrativ për vitet 2011 – 2012 me 33 anëtarë; 2012-2013 me 46 anëtarë.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Një praktikë e rekrutimit të stafit akademik
 - Të dhëna për stafin akademik për vitin akademik 2017-2018
 - Ngarkesën mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit ku është i angazhuar.
 - Tabela me udhëheqësit e diplomave dhe nr e studentëve

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik dhe administrativ është i informuar dhe i angazhuar për realizimin e objektivave të programit të studimit dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit, përmes dokumentacionit rregullator i cili është i publikuar në intranet, si dhe mbledhjeve të departamentit. Performanca e angazhimit vlerësohet nga kontrollohet e vazhdueshme të Komisionit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, pyetsorët me studentët dhe vlerësimeve të shefit të departamentit, të cilat bëjnë edhe rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e kërkuar, në përputhje me objektivat, strategjinë dhe aktet rregullatore në fuqi. Ku dokumentacion depozitohet pranë zyrës së burimeve njerëzore dhe përbën dokumentacionin e çdo pedagogu</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim të njëjësive bazë, departamenteve. Çdo anëtar i departamentit ka të drejtë të bëjë propozime dhe të argumentojë përpara kolegëve ndryshimet e propozuara. Nëse vendimi miratohet në nivel Departamenti kalon për miratim në Senatin Akademik. Ndryshimet e realizuara në programin e studimit master profesional në shkenca politike janë miratura me vendimin e senatit akademik Nr. 7 të datës 14.09.2016</p> <p>Në rekrutimin e personelit akademik merret në konsideratë kërkesat ligjore dhe përcaktimet në rregulloren e brendshme. Kështu një pedagog nuk mund të zhvillojë më shumë se 4 lëndë në vit. Në programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politike, aktualisht janë të angazhuar në mësimdhënie gjithsej 6 pedagogë nga të cilët 5 janë personel akademik efektiv (PAE) të gjithë me grada dhe tituj, përveç një pedagogu. Ndër vite pedagogët e këtij programi studimi kanë qënë me tituj dhe grada shkencore përveç se në rastin e 2 pedagogëve.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve në institucion, në bashkëbisedimin me zyrën e burimeve njerëzore dhe pedagogët, konstatojmë se institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren. Kriteret shpallen publikisht (institucioni publikon shpalljet rregullisht në ëbsite dhe në gazetën Mapo) dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Institucioni i kishte dhënë një rëndësi të madhe rekrutimit të stafit të ri që kishte përfunduar studimet në universitete të Europiane. Gjatë takimit me dekanin e fakultetit dhe shefin e departamentit, konstatojmë se institucioni ndiqte disa procedura të veçanta për integrimin e stafit të ri të rekrutuar. Institucioni zhvillonte një javë trajnim për stafin e ri, cili konsistonte në metodologjin e mësimdhënies dhe anën pedagogjike.

Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë i angazhuar për realizimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Shkenca Politike me profile ka qenë përgjithësisht mbi 70% e personelit akademik, dhe aktualisht ka vetëm një pedagog të jashtëm (programi mbulohet në masën 83% nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë). (Të dhëna Tabela 3 Aneks: 2012-2013 (66%), 2013-2014 (71%), 2014-2015 (88%), 2015-2016 (78%), 2016-2017 (78%), 2017-2018 (83%).

Gjithashtu konstatojmë se kualifikimi i stafit akademik është adekuat. I gjithë personeli akademik i angazhuar në vite në këtë program studimi ka qënë me grada dhe tituj, përveç 2 rasteve (2 pedagogë në dy vite të ndryshme). Kualifikimi akademik i stafit është në përputhje me lëndët që ata mbulojnë. Një pedagog nuk jep më shumë se 2 lëndë dhe në disa raste janë dy pedagogë që mbulojnë një lëndë të caktuar në mënyrë që të përshtatet natyra e kualifikimit të tyre akademik me natyrën e lëndës në fjalë.

Sa i takon vlerësimin të performancës, UET ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit periodik të personelit. Personeli akademik vlerësohet në mënyrë periodike nga studentët nëpërmjet pyetësorëve dhe fokus grupeve, si dhe nga përgjegjësi i departamentit, nëpërmjet vizitave të paracaktuara në auditor, një herë në vit sidomos për pedagogët e rinj. Pyetësorët përpunohen nga KSBC dhe më pas i dërgohen shefit të departamentit, ky i fundit ja bëntë të ditur anëtarëve të stafit. I gjithë dokumentacioni depozitohet pranë zyrës së burimeve njerëzore dhe ishte pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të performancës së pedagogut.

	<p>Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante punësimi pranë zyrës së burimeve njerëzore.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit ka titullin “Profesor i asociuar” dhe është pedagog me eksperiencë akademike.</p> <p>Të gjithë titullarët e lëndëve në programin e studimit Master Profesional në Shkenca Politke, për vitin akademik 2017-2018 kanë të paktën gradë shkencore, përveç një pedagogu u cili është në proces doktorature dhe ndan lëndën me një pedagog me gradë shkencore. Raporti midis personelit akademik me tituj dhe atyre me grada: 1 pedagog me titullin Profesor i Asociuar, 4 kanë gradën doktor shkencash/PhD, ndërsa vetëm 1 pedagog është doktorant. Ky raport ka qënë më i mirë ndër vite, nga 2012 deri 2017 raporti i pedagogëve me tituj dhe atyre vetëm me grada shkencore ka qënë pothuaj 50:50, 1 Prof.Dr. dhe 3 Prof. Asoc.Dr dhe 4 Dr/PhD, në vetëm një rast ka patur një pedagog në proces doktorature.</p> <p>Drejtimesit e institucionit dhe përgjegjësit e departamentit dhe programit janë të punësuar me kohë të plotë në UET, në kontratat e tyre që në vëshguam në zyrën e burimeve njerëzore, ishin të mirëpërcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.</p> <p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt të praktikave profesionale funksionon Zyra e Karrierës dhe Praktikave. Krahas kësaj zyre ndihmëse, institucioni ka dhe një pedagog për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale në nivel masteri për të gjitha programet, i cili ndjek zhvillimin korrekt të praktikës mësimore në institucionin pritis dhe jep vlerësimin e tij në përfundim të kryerjes së praktikës nga ana e studentit. Përveç praktikës në institucione, UET organizon edhe një lëndë “Praktikë dhe Zhvillimi Karriere” 5 ETCS 2 orë në javë, e detyrueshme për studentët master e cila i mundëson ata për tu njohur me elementët praktikë të zbatimit të njohurive të fituara në funksion të përshtatjes me tregun e punës dhe një punësimi të mundshëm të tyre.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p>	<p>Të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi, gjatë vitit të dytë të studimeve përgatisin dhe mbrojnë një punim diplome.</p> <p>Udhëheqësi i tezave të diplomës është një</p>

<p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>pedagog me gradë dhe/ose titull, i cili krahas takimeve të personalizuara, zhvillon edhe seanca metodologjike në auditor me grupin e studentëve që udhëheq, për të garantuar një mbarëvajtje të procesit të shkrimit të punimit.</p> <p>Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga koordinatori e departamentit mbi temat e miratuara të diplomave për vitin akademik 2017-2018, konstatohet se pedagogët udhëheqin një numër studentësh të programit master profesional në shkencë politike më të vogël se 5, kjo pasi raporti pedagogë/studentë (6/4) për programin e studimit është i ulët, çka siguron personel akademik të mjaftueshëm për udhëheqje dhe mbikëqyrjen e diplomës. Megjithatë pedagogët mbulojnë edhe programe të tjera studimi, dhe numri maksimal që një pedagog mund të udhëheqi është 10 studentë.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Anëtarët e departamenti propozojnë temat e diplomës të cilat mund të udhëheqin dhe që janë brenda fushës studimore dhe specializimit të tyre, gjithashtu studentët shprehin interes për temën dhe udhëheqësin me të cilin preferojnë të bashkëpunojnë. Departamenti shqyrton propozimet dhe garanton që tema dhe udhëheqësi i propozuar nga studenti të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit. Nëse nuk konstatohet përputhshmëri, atëherë departamenti cakton një pedagog udhëheqës që i përmbush këto kritere. Studentët njoftohen për listën e miratuar me temat dhe pedagogët udhëheqës. Në rastet kur nuk ka pedagogë të brendshëm të përshtatshëm për të udhëhequr një temë të caktuar, atëherë departamenti ka të drejtë të caktojë një pedagog të jashtëm brenda kritereve të kërkuara.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Personeli administrativ është në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarëvajtjen e procesit akademik. Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe ai administrativ është në nivel institucioni, jo fakulteti.</p> <p>Gjithashtu, nga takimet me studentët e programit konstatohet se institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për t’iu përgjigjur në kohë reale nevojave dhe kërkesave të ndryshme të studentëve.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p>	<p>Personeli i angazhuar në programet e ciklit të dytë realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me</p>

<p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>institucionin, e cila përmban si aneks edhe ngarkesën akademike të shprehur në orë mësimore sipas gradave dhe titujve dhe pozicionit administrativ. Si rregull pedagogët me grada dhe tituj duhet të plotësojnë fillimisht ngarkesën në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve.</p> <p>Ngarkesa në auditor për personelin e angazhuar në programin e studimit shprehet në orë mësimore. Edhe proceset e tjera akademike si udhëheqjet e diplomave, oponencat, mbikëqyrjet e praktikave profesionale konvertohen në orë mësimore. Gjithashtu, pjesë e stafi akademik është i angazhuar edhe në punë administrative.</p> <p>Nga dokumentacioni dhe takimet e realizuara me pedagogë, konstatohet se ngarkesë vjetore në auditor e pedagogëve është e pranueshme, jo më tepër se 4 lëndë dhe më pak se 200 orë (përveç dy pedagogeve të departamenteve të tjera të cilat mbulon edhe lëndë në programet e tjera master, me një ngarkesë totale 254 dhe 364 orësh)³ dhe në vazhdimësi gjykojmë që ngarkesa mësimore duhet të jenë në përputhje me normat e reja të Ligjit të ri të Arsimit të Lartë. Kjo vlen edhe për stafin akademik me kontratë (PAK).</p>
--	--

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Institucioni disponon bazë të dhënash të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik dhe administrative në departamentet përkatës dhe zyrën e burimeve njerëzore. Këto të dhëna përfshijnë gradat dhe titujt, trajnimet e mëtejshme, CV-të, vlerësimet nga shefat e njësieve dhe ato të studentëve, kontratat, ngarkesën dhe detyrat që kryejnë, si dhe dokumentacionin ligjorë të nevojshëm për punësim.</p> <p>Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrative në nivel institucioni, për secilin semester.</p> <p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik përcaktohen në rregullore dhe dokumenta të veçantë, pjesë e broshurës së UET, si dhe publikohen në faqen e internetit dhe media (kryesisht Gazeta Mapo) para fillimit të vitit akademik ose sa herë që ka shpallje të vendeve vakante.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit: Institucioni ndjek procedurat ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren, si dhe mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit dhe vlerësimit të performances. Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve si dhe në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit. Personeli administrativ është në nivel institucioni.

³ Një orë fizike në auditor llogaritet 1.25 orë njësi për efekt ngarkese.

Ndër vite personeli akademik për programin e studimit ka qënë i gjithi me grada shkencore dhe tituj akademikë (përveç se në rastin e 2 pedagogëve), dhe në përgjithësi i punësuar me kohë të plotë pranë UET në masën mbi 70% (përveç se në vitin akademi 2012-2013). Ka një raport të mirë midis personelit akademik me tituj dhe atyre me grada, raporti burra: gra është për tu vlerësuar pasi ka qënë në favor të pedagogëve, dhe përbërja e stafit sipas moshës mundëson harmonizimin më të mirë të stafit me përvojë me stafin e ri. Stafi akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në kontratë (jo më shumë se 4 lëndë dhe jo më shumë se 200 orë në auditor në vit (përveç se në rastin e dy pedagogëve të departamenteve të tjera), si dhe udhëheq tezat e diplomës të miratuara nga departamenti të cilat janë brenda fushës studimore dhe specializimit të tij (numri maksimal që një pedagog mund të udhëheqë është 10 studentë). Në vazhdimësi ngarkesa akademike të jenë në funksion të cilësisë akademike të programit dhe në përputhje me normat e reja të Ligjit të ri të Arsimit të Lartë. Ndërkohë praktikat profesionale, sigurohen nga Zyra e Karrierës dhe Praktikave ose nga vetë studentët nëse janë në marrëdhënie pune dhe mbikëqyren nga një pedagog në nivel masteri për të gjitha programet. UET aplikon një praktikë të mirë pasi ofron një lëndë "Praktikë dhe Zhvillimi Karriere" të detyrueshme për studentët master.

Standardet janë plotësuar

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit dhe nga vizita në institucion, konstatojmë se mjediset e Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara, pjesë e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Edukimit, janë të mjaftueshme si nga numri ashtu edhe nga sipërfaqja, si për sa i përket zyrave për stafin (salla e departamentit, zyra për përgjegjësinë departamentit dhe ajo e koordinatorit) dhe sallave për leksione dhe seminare. Gjithashtu konstatojmë se sallat e leksioneve dhe një pjesë e sallave të seminareve kishin video-projektorë që lejonin prezantimin e leksioneve nga pedagogët dhe prezantimet individuale ose në grup të studentëve. Ambjentet e shërbimeve të tjera janë në nivel institucioni për të gjithë studentët e universitetit. Institucioni ka një Bibliotekë të pajisur me tituj librash specifikë për programin e studimit (kryesisht tituj autorësh të huaj të përkthyer nga UET-press), si dhe bibliotekën online me akses në disa burime bibliografike si Questia, EBSCO, Sage. Universiteti ka 4 laboratorë mësimorë informatike, mbulim me sinjal WiFi që lejon studentët dhe pedagogët të aksesojnë lirisht ëëbin dhe platformën LMS (Learning Management System) të menaxhimit të mësimdhënies online.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për (Fakultetin/përgjegjës) për Programin e studimit

- Salla për leksione **10 salla leksionesh me sipërfaqe gjithsej prej 1510 m² (1,515 vende) dhe 9 salla me sipërfaqe gjithsej prej 900 m² (630 vende)**

- Klasa për seminare **14 klasa për seminare me sipërfaqe gjithsej prej 630 m²** (490 vende)
- Salla për aktivitete promovuese **2 ambjente me sipërfaqe gjithsej prej 180 m² (150 vende)**
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale **Nuk është e aplikueshme për këtë program studimi**
- Laboratorë për lëndët **Nuk është e aplikueshme për këtë program studimi.**
- Laboratorë informatike **Nuk është e aplikueshme për këtë program studimi**
- Salla interneti **1 salla interneti me sipërfaqe gjithsej prej 160 m² (80 vende)**
- Salla për bibliotekë **1 sallë për bibliotekë me sipërfaqe 300 m²**
- Mjedis për fotokopjime, librari etj **1 mjedis me sipërfaqe 150 m²**
- Zyrë informacioni për studentët **2 mjedise**
- Nyje hidrosanitare **40 të tilla me sipërfaqe gjithsej 240 m²**

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Rektorin/zv. Rektorin/Dekanin/zv. Dekanin/Kancelarin **9 zyra me sip. 320 m²**
- Zyra për sekretarinë mësimore **9 me sip. 285 m²**
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore **9 zyra me sip. 360 m²**
- Zyra për personelin akademik **25 zyra me sip. 400 m² dhe 1 zyre me sip. 150 m²**

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

➤ Inventari i librave

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni ndodhet në Blv. Gjergj Fishta që prej shtatorit 2007 dhe infrastrukturura e tij ka hapësirat e nevojshme dhe komode për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Të gjitha godinat ndodhen në një kompleks çka lejon menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për zbatimin e politikave arsimore dhe programe të studimit. Institucioni, gjithashtu ka një shfrytëzim optimal të infrastrukturës në dispozicion, pasi mësimi në ciklin e parë të studimeve zhvillohet paradite ndërsa në programet e ciklit të dytë pasdite gjatë ditëve të javës (për programin e studimit në fjalë e mërkurë deri e premtë nga ora 17:00 – 20: 00 si dhe ditën e shtunë nga ora 9:00 – 17:00).</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vëzhgimeve në bibliotekë vërejmë se UET vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi.</p> <p>Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit dhe përgatitjen e tezës.</p> <p>Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë elektronik si: Questia, Sage të cilat përmbajnë botime periodike të nevojshëm për realizimin me sukses të programit të studimit dhe projektit kërkimor të diplomës. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online).</p> <p>Përgjegjësi i programit harton një plan vjetor të konsultuar me anëtarët e departamentit për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të. Biblioteka e UET është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Në rregulloren e programit të studimit Master Profesional në Shkenca Politike fondi i botimeve (libra kryesisht të autorëve të huaj por të përkthyer) është 151. Ndërkohë fondi për programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit përmban rreth 3000 tituj në shqip, 785 tituj në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht), 78 revista periodike në shqip dhe po kaq në anglisht.</p> <p>Orari i Bibliotekës është përshtatur programeve të studimit dhe zakonisht funksionon nga e Hëne në të Premte 9:00-20:00 dhe të Shtunë 9:00:17:00, kurse gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur. Megjithatë studentët nuk e shfrytëzojnë sa duhet bibliotekën e Universitetit sic doli në pah edhe gjatë vizitës në institucion, ndonëse ekziston një fond i konsiderueshëm librash si dhe biblioteka online Questia apo database EBSCO etj.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i</p>	<p>Nga vëzhgimi në terren dhe duke e ballafaquar me të dhënat e institucionit konstatojmë se ka në sasi të mjaftueshme ambientesh: klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimit Master Profesional në Shkenca Politike.</p> <p>Gjithashtu konstatojmë se pajisjet ndihmëse si monitorë dhe kompjutera në salla leksionesh dhe seminaresh funksiononin dhe na u bë me dije se studentët i përdornin për prezantimet individuale dhe në grupe të punimeve të kurseve të ndryshëm. Institucioni ka laboratorë por këta nuk janë të</p>

studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;	aplikueshëm për këtë program specifik studimi. Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, si pjesë e programit Master Profesional në Shkenca Politike.
Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	
Konkluzionet e vlerësimit: Infstrukturura e universitetit ka hapësirat e nevojshme dhe komode për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, dhe institucioni bën një shfrytëzim optimal të kësaj infrastrukture duke zhvilluar programet e cikli të dytë pasdite dhe ditët e shtuna. Universiteti vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi. Databaza e Bibliotekës në institucion dhe ajo elektronike ka literaturë të mjaftueshme, megjithatë prezenca fizike në ambjentet e bibliotekës është jo e shpeshtë. Gjithashtu institucioni ka në dispozicion pajisje ndihmëse si monitorë dhe kompjutera për prezantimet individuale dhe punë në grup. Institucioni ka gjithashtu laboratorë informatike.	
Standardet janë plotësuar	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimet e financimit bazohen kryesisht tek tarifa e shkollimit (rreth 85%). Ndërsa një kontribut tjetër i burimeve financiare lidhet me aktivitetet tregtare (qeradhenie, parkim etj.) në masën 12%. Nga viti 2013, institucioni ka pasur të ardhurat nga grantet për kërkim në nivelin 2-3% të totalit të burimeve financiare. Kapacitetet menaxhuese janë brenda normave të specifikuara nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi **(në përqindje):**

- Grantet për kërkim **3 %**
- Konsulencat, shërbimet **0 %**
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit **85 %**
- Sponsorizimet **0 %**
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) **0 %**
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj **0 %**
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj **12 %**

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kosto e studimit për student viti akademik 2016-2017 182.500 lek (nr i studentëve 4066), ndërkohë që kosto për student në vitet paraardhëse (2014-2015, 2015-2016) ka qënë më e ulët (175.980, 165.100 respektivisht) sidomos kur numri i

studentëve ka qënë më i madh (viti 2015-2016 4.149 studentë) kjo pasi burimi kryesor i financimit janë tarifat për dhe gjatë shkollimit. Përveç sigurimit të qëndrueshmërisë të numrit të nevojshëm të studentëve, shtimi i të ardhurave nga burime të tjera si grante për kërkim apo konsulenca shërbimi dhe trajnime të vazhdueshme do të mundësojë uljen e kostos së studimit për student.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Projekte për Departamentin e Shkencave Sociale te Aplikuara

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>UET kryen raport auditit periodit të përvitshëm në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatese, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët në nivel institucional.</p> <p>Raporti i auditit përmban një pasqyrë të granteve të përfituara dhe shërbimeve të ofruara në nivel institucioni.</p> <p>Nga shqyrtimi i të dhënave të cilat janë në nivel institucioni është e vështirë që të përlogaritet qëndrueshëria e programit të studimit, megjithatë nisur nga fakti se burimi kryesor i të ardhurave vjen nga tarifa e shkollimit (në masën 85%) dhe numri i studentëve në këtë program është shumë i vogël rekomandohet që departamenti të sigurojë të ardhura shtesë nga burime të tjera si grante për kërkim apo konsulenca shërbimi dhe trajnime të vazhdueshme do të mundësojë uljen e kostos së studimit për student.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni ka raporte në lidhje me kostot për programet e studimi në lidhje me detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet specifike të programit të studimit etj., për të cilat kryhet dhe auditimi i përvitshëm.</p> <p>Nëse konsiderojmë numrin e studentëve si burim parësor të të ardhurave, në këtë program studimi, numri i studentëve të rinj të regjistruar është problematik</p>

(numri i studentëve për vit është jo më i madh se 4 dhe në disa raste nuk ka patur studentët të regjistruar), ndërkohë që institucioni ka një numër të konsiderueshëm studentësh në programet e tjera të studimit si dhe është i angazhuar në grante kërkimore është në rritje.

Konkluzionet e vlerësimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve në dispozicion dhe gjithashtu nga takimet me personelin në IAL konstatojmë se UET kryen raport auditit periodik të përvitshëm në lidhje me të ardhurat dhe kostot e programeve të ofruara në nivel institucional. Programi i studimit financohet kryesisht (në masën 85%) nga të ardhurat që vijnë nga tarifa e shkollimit, sikundër dhe nga të ardhura që gjenerojnë nga aktivitete tregtare të IAL (në masën 12%) dhe grantet për kërkim shkencor (3 %). Institucioni dëshmon se paraqet një qëndrueshmëri në gjenerimin e të ardhurave referuar numrit total të studentëve (por jo numrit të studentëve të regjistruar në këtë program studimi i cili është shumë i ulët) si dhe angazhimit në grante kërkimore i cili është në rritje. Rekomandohet që departamenti të shtojë përpjekjet për të siguruar numrin e nevojshëm të studentëve, si dhe të sigurojë të ardhura shtesë nga burime të tjera si grante për kërkim apo konsulenca shërbimi dhe trajnime të vazhdueshme të cilat do të mundësojë uljen e kostos së studimit për student dhe do të krijojnë departamentit një qëndrueshmëri financiare më të sigurt në zhvillimin e këtij programi.

Standardet janë plotësuar kryesisht

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit si dhe nga vizita dhe intervistat në Institucion, konstatojmë se Njësia e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë (Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - KSBC) e institucionalizuar si njësi e përhershme në strukturën organizative të universitetit në Janari 2011, ka rregulloren e saj dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. KSBC-ja vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore, administrative dhe financiare të UET-it. KSBC-ja ka asistuar në hartimin e RVB-së, në marrjen e masave për adresim të kërkesave dhe ankesave të studentëve, në kontrollin dhe asistencën që u jep fakulteteve dhe departamenteve të vecanta, si Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara. Gjithashtu, vlerësojmë si praktika të mira në funksion të sigurimit të cilësisë në institucion është përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm, ngritjen e organeve këshilluese si Bordi i Besimit dhe Bordet e Tregut të Punës, përfshirjen në projekte evropiane që kanë në fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë (projekti TEMPUS "ENCHASE" dhe Erasmus+: QAINAL), të cilat i shërbejnë përditësimit me praktika të mira të sigurimit të cilësisë, sigurojnë më shumë objektivitet dhe paanshmëri në gjykimet dhe rezultatet e

vlerësimin, si edhe ofrojnë feedback dhe rekomandime për të përmirësuar më tej praktikën e zbatuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - o Sa anketime kanë bërë me studentët: **2 anketime në vit dhe fokus-grupe**
 - o Sa studentë janë anketuar **N/A**
 - o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë: **Janë përpunuar të gjitha anketimet dhe të dhënat që kanë dalë janë sasiore dhe cilësore që lidhen kryesisht me të nxënit dhe aftësitë pedagogjike të pedagogëve.**
 - o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm **KSBC raporton të dhënat e agreguara për pedagog pranë departamentit dhe zyrës së burimeve njerësore së bashku me rekomandimet përkatëse**

KSBC ka strategjinë dhe plan-veprimin vjetor për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET. Ajo zhvillon sondazh online dhe një sondazh në fokus-grup (shkurt dhe qershor-korrik) me studentët pas përfundimit të semestrit.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë
KSBC zhvillon veprimtarinë sipas një plani kalendar të përvitshëm, në të cilin programon kontrollet e sektorëve dhe proceseve. KSBC raporton dhe informon drejtuesit e fakulteteve për gjetjet me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm.
- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti
KSBC organizon dhe menaxhon pyetëtorin me studentët, në përfundim të çdo semestri për të gjitha lëndët dhe pedagogët e të gjitha programeve të studimit, si dhe 'fokus grupe'.
- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
Të dhënat e përpunuara, shërbejnë për vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog nga drejtuesit e njësive akademike.
- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
KSBC organizon trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësidhënies, si dhe njohjen e rregullore të brendshme të UET (sidomos të pedagogëve të rinj dhe atyre të jashtëm). *Staff Development Days* është trajnimi për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, zhvillimi i moduleve të trajnimit bëhet në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit.
Një tjetër aktivitet që realizonte KSBC ishte edhe shqyrtimi nga ana formale e sylabuse. KSBC sigurohet që formati i përdorur të jetë ai i duhuri, sylabusi të përmbaj të gjithë elementët e nevojshëm, shkrimi të jetë i njëjtë në të gjithë sylabusin etj.
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Raportin e KSBC
 - Formularë anketimi
 - Rregullone e KSBC

- Planin e veprimit të aktiviteteve kryesore të KSCB

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitës në Institucion, komstatuam se; UET ka metodologji të brendshme për matjen e ecurisë së programeve të studimeve.</p> <p>UET kryen anketime dy herë në vit për cdo lëndë të zhvilluar në secilin program studimi, përfshirë edhe atë të Masterit Profesional në Shkenca Politike si dhe fokus grupe me studentë të cilët pyeten për vlerësimin e kurrikulës, stafin pedagogjik dhe shërbimet e tjera studentore.</p> <p>Resultatet e agreguara të këtyre anketimeve janë pjesë e vlerësimit të performancës së pedagogëve dhe ndihmojnë në evidentimin e problematikave dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>KSBC ka strategjinë dhe plan-veprimin vjetor për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET. Ajo zhvillon sondazh online dhe fokus-grup (shkurt dhe qershor-korrik) me studentët pas përfundimit të semestrit. Gjithashtu, drejtues të departamentit apo titullarë të tjerë kryejnë visita monitoruese/vlerësuese për zhvillimin e lëndës në auditor nga pedagogu. KSBC kryen edhe vlerësime të drejtpërdrejta në lidhje me mbarëvajtjen e zhvillimit të provimeve dhe cilësisë së korrigjimit të tyre, monitorimin e sekretarisë për procesin e hedhjes së notave, realizimine orarit të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve. Të gjitha këto të dhëna dhe rekomandimet përkatëse i raportohen drejtuesve respektive dhe zbatimi i rekomandimeve ndiqet nga vetë KSBC me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm.</p> <p>Një tjetër akritet që realizonte KSBC ishte edhe shqyrtimi nga ana formale e syllabuse. KSBC sigurohet që formati i përdorur të jetë ai i duhuri, syllabusi të përmbaj të gjithë elementët e nevojshëm, shkrimi të jetë i njëjtë në të gjithë syllabusin.</p>
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe	

objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve.</p> <p>Këto raporte janë pjesë e komunikimit dhe diskutimit në nivel rektorati sikurse dhe në nivel departamenti. Gjithsesi këto raporte janë për konsum të brendshëm të institucionit.</p>
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Analiza mbi ecurinë e programeve të studimit bëhet në rang departamenti, duke përfshirë në to edhe mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.</p> <p>Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel Departamenti) dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në “fokus grupe” dhe pyetësorët online, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.</p>
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>UET është akredituar si institucion me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 246, datë 24.07.2009 për Programet e Ciklit të Parë “Bachelor”. Riakredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 12, deri 07. 04. 2017 “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vëzhgimi në vend, na rezulton që institucioni përdor instrumente të tërthorta dhe të drejtpërdrejta për sigurimin e cilësisë. Nga takimi me grupin e KSBC dhe informacionin e marrë mbi punën që kryen, konstatoam që IAL i jep mbështetjen dhe mjetet e nevojshme kësaj njësie për të krijuar të gjitha instrumentat për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Gjithashtu institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedura vlerësimi periodik të veprimtarive didaktike për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve.</p> <p>Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet (p.sh. nëpërmjet mekanizmave vlerësues të performancës)</p>

dhe të vet studentëve (p.sh Turnitin të programeve kompjuterike kundër plagjiaturës) për rëndësinë dhe sigurimin e cilësisë.

KSBC në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit organizon trajnimin e përvitshëm sidomos të pedagogëve të rinj dhe atyre të jashtëm për njohjen e rregulloreve të brendshme të UET dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional.

Konkluzionet e vlerësimit: UET është akredituar si institucion i arsimit të me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 246, datë 24.07.2009 dhe Riakredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”.

Institucioni që nga viti 2011 ka një njësi të përhershme të sigurimit të brendshëm të cilësisë e cila ka rregulloren e saj, një strategji dhe plan veprimi vjetor. KSBC-ja përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për të vlerësuar periodikisht efikasitetin dhe sigurinë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore, administrative dhe financiare të UET-it. Të gjitha rekomandimet përkatëse i raportohen drejtuesve respektive dhe zbatimi i tyre ndiqet nga vetë KSBC me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm. Gjithashtu, vlerësojmë si praktika të mira në funksion të sigurimit të cilësisë përfshirjen e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm, ngritjen e organeve këshilluese si Bordi i Besimit dhe Bordet e Tregut të Punës, dhe përfshirjen në projekte evropiane që kanë në fokus sigurimin e cilësisë (projekti TEMPUS “ENCHASE” dhe Erasmus+ QAINAL), të cilat i shërbejnë përditësimit dhe përmirësimit më tej të praktikave të mira dhe sigurojnë më shumë objektivitet dhe paanshmëri.

Standardet janë plotësuar

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni dhe objektivi i programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Shkenca Politike me profile janë në përputhje me misionin dhe objektivat institucionale, si dhe i përshtatet nevojave të tregut të punës, veçanrisht për sektorin publik, duke u nisur nga vlerësimi i kurrikulës ekzistuese e cila ka ndryshuar pjesërisht në gjashtë vitet e fundit. Planu mësimor është i përpunuar qartë me kreditet që korrespondojnë me lëndët dhe modulet përkatëse, ku orët teorike dhe ato praktike (jashtë auditorit), janë të përcaktuara qartë sikundër e konfirmuam nga syllabuset e çdo lënde por edhe nga bashkëbisedimi me studentë dhe pedagogë. Ky program studimi synon të përgatisë profesionistë të administratës publike, konsulentë si dhe punonjës së OJF-ve të ndryshme, apo specialistë me synim karrierën në institucione publike dhe ato private.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Organizimi i programit të studimit Master Profesional në Shkenca Politike është program studimi me kohë të plotë. Që prej vitit akademik 2016-2017 ky program studimi me vendim të Senati Akademik të UET ofrohet me një kohëzgjatje normale 1 vjeçare me 60 ECTS. Programi i studimit është organizuar në 2 semestra në total. Procesi mësimor është i ndërtuar me **1500 orë studimi**, nga të cilat **600 orë janë në auditor (leksione+seminare) dhe 900 orë janë studimi individual**. Procesi akademik zgjat 28 javë mësimore në auditor dhe 6 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti zhvillon deri në 17 orë mësimore në auditor për javë. Qëllimi i programit të studimit është përgatitja e ekspertëve të lartë, të aftë që të analizojnë në mënyrë të pavarur, të mësojnë se si të debatojnë dhe konkludojnë përfundime në çështje të caktuara të shkencave politike. Ky programin studimi ka si objektiv primar ofrimin e njohurive të duhura për të qenë specialist i shkencave politike dhe me fokus të veçantë politikat publike dhe sjelljet/strategjitë politike.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 28 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 14 javë mësimore në auditor

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Kurrikula e këtij programi ka gjithsej 1 lëndë në disiplina të formimit të përgjithshëm metodologjik (6 ECTS), 3 lëndë të formimit karakterizues (18 ECTS gjithsej) 4 lëndë me zgjedhje në disiplina të ngjashme që krijojnë 2 profilet (12 ECTS gjithsej për cdo profil), si dhe praktikën profesionale me 10 ECTS dhe tezën e diplomëse me 14 ECTS. Ndarja e ngarkesës për lëndë është e barabartë (6 ECTS çdo lëndë) dhe pesha e lëndëve që përbëjnë profilin është 2 lëndë.

(Tabela 8 e Aneksit)

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për Leksionet 28 orë në auditor dhe 34.5 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 14 orë në auditor dhe 36 orë punë e pavarur e studentit
- Për Projekt/detyra/ushtrime 18 orë në auditor dhe 19.5 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 220 orë në auditor dhe 30 orë punë e pavarur e studentit
- Për Punim diplome 20 orë në auditor dhe 330 orë punë e pavarur e studentit

Në përgjithësi kjo ndarje është në përputhje me kërkesat e IAL-it dhe dispozitave të akteve nënligjore dhe ndryshimeve respektive që ka pasur në ligj, si dhe garantojnë cilësi në mënyrën e vlerësimit të studentëve.

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Plani mësimor ka ndryshuar në 3 lëndë. Konkretisht, Lënda 1 Konceptim dhe menaxhim fushatash ishte lëndë e detyrueshme për profilin Sjellja dhe Strategjitë Politike kaloi lëndë e detyrueshme në kategorinë B për të dyja profilet, në profil kjo

lëndë u zëvendësua me lëndën Lëvisjet e reja politke. Lënda 2 Menaxhim dhe Vleresim Projektsh ishte lëndë opsionale në kategorinë C kaloi lëndë e detyrueshme në kategorinë B. Lënda 2 Praktika profesionale ishte me 8 kredite ECTS u bë me 10 kredite ECTS. (Tabela 8 e Aneksit)

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e duhur dhe ekspertizën e nevojshme në lëndët përkatëse. Nga të dhënat për vitet 2012 – 2018 pjesa më e madhe e personelit akademik vazhdon të jetë e angazhuar në të njëjtat lëndë. (Tabela 9 e Aneksit)

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset i kanë të gjitha elementët. Ato janë të standartizuara për të gjitha modulet si më poshtë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset trajtojnë jo vetëm aspekte teorike dhe metodologjike për tema të caktuara por edhe çështje praktike dhe raste studimore. Literatura është bashkëkohore dhe e përshtatshme për këtë program studimi.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Syllabuset (honor course)
- Syllabuse të lëndëve të programit
- Tabela e stafit akademik të lidhur me lëndët që mbulojnë në këtë program

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>UET në përputhje me kërkesat e ligjit ofron programin e studimit në ciklin e dytë Master Profesional në Shkenca Politike, me kohë të plotë për një periudhë 1 vjecare, të organizuar në module dhe të vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program gjithsej ka 60 kredite ECTS.</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek këtë program studimi është 60 kredite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të	

institucionit.

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;

Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike i përmbush synimet e vendosura. Ai ofron njohuri të thelluara teorike e praktike, si për kërkim shkencor ashtu edhe për trajnim të mirëfilltë profesional. Ky program i krijon studentit aftësi për punë kërkimore, duke krijuar bazat për vazhdimin e studimeve të mëtejshme për ata që synojnë një karrierë akademike, si dhe njohuritë e duhura për të qenë specialist i nivelit të lartë në politikat publike dhe sjelljet politike duke i krijuar studentit mundësi punësimi pas përfundimit me sukses të programit të studimit në institucione ose organizata të ndryshme publike apo private si dhe në një numër sektorësh që fokusohen në analizën e politikave publike dhe sjelljes politike.

Kurrikula e këtij programi ka gjithsej 1 lëndë në disiplina të formimit të përgjithshëm metodologjik (6 ECTS), 3 lëndë të formimit karakterizues (18 ECTS gjithsej) 4 lëndë me zgjedhje në disiplina të ngjashme që krijojnë 2 profilet (12 ECTS gjithsej për çdo profil), si dhe praktikën profesionale me 10 ECTS dhe tezën e diplomëse me 14 ECTS. Ndarja e ngarkesës për lëndë është e barabartë (6 ECTS çdo lëndë) dhe pesha e lëndëve që përbëjnë profilin është 2 lëndë.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;

Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.

Organizimi i programit të studimit, lëndët e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke u dhënë mundësi të plotësojnë njohuritë dhe të sqarojnë paqartësitë gjatë semestrit. Gjithashtu institucioni përdor si metoda vlerësimi; dëgjimet në auditor, testimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, provime për module dhe praktikë, si dhe detyra kursi dhe prezantime individuale dhe në grup. Gjatë vizitës te sekretaria mësimore,

	<p>nëpërmjet përzgjedhjes së kampioneve, pamë se si kriteret vlerësuese ishin provimi përfundimtar me shkrim, punimi dhe prezantimi i tij para klasës, si dhe pjesmarrja e studentëve. Këta komponentë kishin përqindjet korresponduese që merreshin për bazë për vlerësimin përfundimtar ndërkohë që studentët të cilët plotësojnë më shumë se 3 mungesë duhet të frekuentojnë lëndën përsëri.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi është hartuar duke iu referuar përvojave bashkëkohore europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës. UET ka kryer për herë të parë një Studim të Tregut me studentët Alumni përgjatë vitit akademik 2016-2017 për të vlerësuar programet e studimit dhe shërbimet studentore të ofruara në nivelin master.</p> <p>Konstatohet se ndarja e ngarkesës për lëndë është e barabartë (6 ECTS çdo lëndë) përveç praktikës dhe punimit të diplomës (10 ECTS dhe 14 ECTS respektivisht), dhe pesha e lëndëve që përbëjnë profilin është 2 lëndë.</p> <p>Institucioni aplikon një praktikë të mirë, pasi ka pedagog përgjegjës të specializuar për Grup-lëndë të caktuara të cilat i takojnë fushës së shkencave politike.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Aftësimi profesional i studentëve realizohet përmes praktikës profesionale, e cila kryhet gjatë semestrit të dytë, dhe zgjat gjithë semestrin, por edhe përmes lëndëve me karakter aplikativ që ofrohen në programin e studimit. Për Praktikën Profesionale 220 orë realizohen në auditor dhe 30 orë janë punë e pavarur e studentit (total 10 ECTS).</p> <p>Aftësimi për kërkim shkencor realizohet përmes lëndëve të metodologjisë, seancave metodologjike për punimin e diplomës dhe konsultimin e vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës. Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET-it dhe drejtimet e miratuara për kërkimin shkencor.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profile ofrohet në përputhje me nevojat e tregut për ekspertë në fushën e politikave publike dhe strategjive politike. Programi trajton çështje me rëndësi dhe aktuale të proceseve politike dhe në veçanti të politikave publike, sjelljes elektorale dhe strategjive politike.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike me profile synon të plotësojë nevojat e tregut për ekspertë në fushën e politikave publike dhe strategjive politike.</p>

Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Gjatë hartimit të programit të studimit Departamenti është konsultuar me përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të tregut të punës, si dhe në vazhdimësi të programit mbledhë opinionin e studentëve të angazhuar në këtë program pasi pjesa më e madhe e tyre janë të punësuar. Gjithashtu, rekomandimet e Bordit të Tregut të Punës pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve dhe në gamën e lëndëve me zgjedhje që ofrohen.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Shkenca Politike synon të plotësojë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit makro-ekonomik;</p> <p>Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, ka kryer një studim tregu me studentët Alumni në nivel Institucioni, i cili përfshin ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> -mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; -një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Vumë re se programi i studimeve Master Profesional në Shkenca Politike nuk bien ndesh me interesat kombëtare, për më tepër avancon axhendën e bashkëpunimit rajonal dhe të fqinjësisë së mirë.</p> <p>Gjithashtu programi i studimit synon të ndihmojnë në promovimin e praktikave të mira të vendit në fushën e shkencave politike dhe bashkëpunimit rajonal.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezen që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Nuk aplikohet për këtë program</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi është ofruar në dy variante me kohëzgjatje normale 1.5 vjet me 90 kredite ECTS, dhe që prej vitit akademik 2016-2017 ky program studimi me vendim të Senati Akademik të UET ofrohet vetëm me 60 ECTS me një kohëzgjatje normale 1 vjeçare.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo</p>	<p>Nuk aplikohet për këtë program</p>

më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;

Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.

Institucioni përdor forma alternative të informimit të studentëve për aktivitetet e programit të studimit. Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të UET-it. Gjithashtu studentët në fillim të secilit semestër pajisen me të gjithë silabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar. Gjithashtu prej 2 vitesh, institucioni përdor sistemin MOODLE (UET LMS), i cili bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive, etj. Gjithashtu nëpërmjet këtij sistemi studenti ka mundësi të shikojë vlerësimin për komponentë të caktuar dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet.

Një mbledhje e departamentit në muaj është e hapur për studentët, ku diskutohen aspekte të procesit mësimor ngushtësisht të lidhura me jetën studentore dhe ku studentët mund të shprehin mendimin e tyre për çështje të programit, rregullores, apo propozime për përmirësim.

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Institucioni ka përcaktuar në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplomë, miratimi i temës dhe pedagogut udhëheqës nga Departamenti, procesi i shkrimit të tezës, kalendari i seancave metodologjike, e deri tek formatimi konkret i punimit, dorëzimi dhe mbrojtja.

Punimi i diplomës është vlerësuar me 14 kredite ECTS dhe zhvillohet në semestrin e dytë.

Konkluzionet e vlerësimit:

UET ofron programin e studimit në ciklin e dytë Master Profesional në Shkenca Politike, me kohë të plotë dhe prej vitit akademik 2016-2017 vetëm për një periudhë 1 vjeçare, të organizuar në module dhe të vlerësuar në kredite (60 ECTS në total). Programi i studimit ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thëllon më tej njohuritë dhe aftësitë teorike e praktike, si për kërkim shkencor ashtu edhe për trajnim të mirëfilltë profesional. Aftësimi profesional realizohet përmes praktikës profesionale si dhe përmes lëndëve me karakter aplikativ ndërsa aftësimi për kërkim shkencor realizohet përmes lëndëve të metodologjisë dhe punimit të diplomës (seancave metodologjike për punimin e diplomës dhe konsultimin e vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës). Programi është hartuar duke iu referuar përvojave bashkëkohore, dhe në vazhdimësi në konsultim me përfaqësues të sektorëve të ndryshëm (Bordit të Tregut të Punës) dhe opinionit të studentëve (Studimi me Alumnit). Vlerësojmë se studentët marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe aktivitetet përbërëse të tij, nëpërmjet koordinatores së departamentit dhe elektronikisht nëpërmjet sistemit MOODLE LMS. Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet prezencës në auditor, provimeve dhe shkrimit të eseve. Mos-prezenca në më shumë se 3 tema dhe minimumi 80

përqind frekuentim e kthen studentin të ri-frekuntojnë lëndën.

Kurrikula e këtij programi ka gjithsej 1 lëndë në disiplina të formimit të përgjithshëm metodologjik (6 ECTS), 3 lëndë të formimit karakterizues (18 ECTS gjithsej) 4 lëndë me zgjedhje në disiplina të ngjashme që krijojnë 2 profilet (12 ECTS gjithsej për cdo profil), si dhe praktikën profesionale me 10 ECTS dhe tezën e diplomës me 14 ECTS. Ndarja e ngarkesës për lëndë është e barabartë (6 ECTS çdo lëndë) dhe pesha e lëndëve që përbëjnë profilin është 2 lëndë.

Standardet janë plotësuar

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Zbatimi i planit mësimor planifikohet dy muaj përpara fillimit të vitit akademik nga Dekani i Fakultetit dhe Përgjegjësit e Departamenteve, gjithësesi për koordinimin e vazhdueshëm të mësimdhënies Departamenti organizon mbledhje të zakonshme çdo javë. Organizimi i mësimdhënies është dhënë me ndarjen e orëve në leksione dhe seminare, si dhe ndarjen tematike të orëve teorike dhe praktike. Në cilkin e dytë lëndët organizohen në grupe leksion/seminari (3 orë/javë) me rreth 50–60 studentë. Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me orarin. Sekretaria Mësimore mban evidencat për zhvillimin e orëve të leksioneve/seminareve dhe raporton për orët e pazhvilluara te Dekani. Ngarkesa e pedagogëve me kohë të plotë ishte në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë, më përjashtim të ndonjë rasti ku ngarkesa totale e pedagogëve është më shumë se 200 orë në auditor, edhe ngarkesa akademike e PAK-ve. Teknologjia e mësimdhënies përfshin përdorime të multi-medias, në lëndë të caktuar ishte në nivele të mira dhe një pjesë e studentëve kanë kryer punë kërkimore në terren nën udhëheqjen e pedagogëve. Aktivizimi i studentëve në aktivitete ekstrakurrikulare ngelet gjithësesi një praktikë e mirë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Format e organizimit të mësimdhënies janë leksionet, seminarat, detyrat e kursit dhe punime të parashikuara në programin mësimor, sipas rregullores së këtij programi studimi.

Sipas të dhënave të planit mësimor, syllabuseve dhe takimit me stafin dhe studentët, mësimdhënia realizohet kryesisht me leksione.

- Seminarat zhvillohen rregullisht dhe në përputhje me planin mësimor.
- Ushtrimet janë pjesë e rregullt e detyrave të kursit.
- Labororet nuk janë të aplikueshëm për këtë program studimi.
- Praktikë lëndore **Nuk ka**
- Praktikë profesionale **Institucioni nuk ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale, pasi praktikat sigurohen nga vetë studentet.**

- Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive janë **me shkrim dhe me gojë**. Format e kontrollit dhe formula e vlerësimit të studentit për cdo lëndë, është pjesë e

syllabus-it të lëndëve. Në fillim të cdo semestri pedagogët u bëjnë të ditur studentëve modelin dhe formulën e zgjedhur për vlerësimin e njohurive të tyre përgjatë semestrit dhe në fund të tij. E shprehur në %, ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive (10%), plotësimi i detyrave të kursit (20%), testimet gjatë vitit (30%) dhe provimi përfundimtar (40%).

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësive etj

Numër i konsiderueshëm studentësh të aktivizuar në projekte shkencore në rang fakulteti (10) dhe departamenti (3), si dhe për punime shkencore individuale të pedagogëve (5).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Ngarkesa në auditor për personelin e angazhuar në programin e studimit. Viti akademik: 2016-2017, 2017 – 2018

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedurat e pranimit të studentëve për herë të parë apo atyre të transferuar janë konform ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi sikundër konstatuam në zyrën e sekretarisë. Koha mesatare e studimeve është 1 vit akademike, duke filluar nga viti akademik 2016-2017. Kalueshmëria e studentëve është e mirë pasi pjesa më e madhe e studentëve arrin që të mbylli studimet brenda harkut kohor normal (Numri i studentëve të regjistruar në programin e studimit nga viti 2012 e deri më 2017 është 14 studentë, nga të cilët 8 janë diplomuar (Shih Tabela 15 në Aneksit). Përsa i përket punësimit, niveli është i kënaqshëm mbi mesataren për të punësuarit në profesion (64%) dhe si nivel i përgjithshëm punësimi (86%), përfshi edhe punësimin jo në përputhje me diplomën. Mendojmë se informimi i studentëve në lidhje me karrierën ishte në nivele të kënaqshme duke qenë se ishte një zyrë e posacme me një koordinator me kohë të plotë në dispozicion për këtë qëllim.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve ishin të qarta dhe në përputhje me rregulloren e brendshme të Universitetit. Më specifikisht dokumentat që duhet të paraqesin studentët për tu regjistruar në këtë program studimi janë:

- Diplomë e maturës shtetërore së bashku me çertifikatën e notave.
- Dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit.
- Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011)
- Fotokopje e kartës së identitetit, letër njoftimit ose pasaportës.

- 4 fotografi
- Formulari i aplikimit

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Nota mesatare në hyrje e studentëve dhe nota mesatare në dalje ndryshojnë me afërsisht një notë plus. Programi i studimit ka ofruar cilësi nëse konsiderojmë edhe faktin që cilësia në hyrje e disa studentëve ka qënë notë kaluese dhe vlera më e ulët e notët kaluese të studentëve të diplomuar ka qënë mbi 6.

(Shih Tabela 15 e Aneksit)

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Studentë të rregjistruar për vitin e I (2017-2018) janë **4 studentë** të regjistruar për herë të parë, nota mesatare e tyre është 7.4.

(Shih Tabela 15 e Aneksit)

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Viti 2016-2017: **3 studentë** Nota Mesatare në dalje **7.6**

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
I kufizuar.

Të dhëna për punësimin e studentëve

12 studentë të diplomuar të punësuar për vitet akademike 2012-2016;

(Shih Tabela 14 e Aneksit)

Numri total të diplomuarve

8 për vitet 2014-2017

(Shih Tabela 15 e Aneksit)

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

9 studentë për vitet akademike 2011-2016

(Shih Tabela 14 e Aneksit)

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

12 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën

(Shih Tabela 14 e Aneksit)

Ndërkohë që numri i studentëve të diplomuar dhe të punësuarve pas diplomimit është në nivele të mira pasi pjesa më e madhe e studentëve arrijnë që të mbyllin studimet e tyre në harkuan kohor të parashikuar, dhe niveli i përgjithshëm i punësimit është 86%, ku më shumë se gjysma (64%) janë të punësuarit në përputhje me diplomën.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

➤ Mesatarja në hyrje dhe dalje e studentëve

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe e përforcuar nga vizita në terren, konstatohet se pranimi në ciklin e dytë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin.</p> <p>Nuk ka kriteret specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi, përveç se kriterëve ligjorë të zotërimit të së paku diplomën universitare “Bachelor” me 180 kredite ECTS dhe dëshmisë së provimit të gjuhës së huaj mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare dhe në përputhje me udhëzimet e MAS mbi nivelin e gjuhës së huaj.</p> <p>Në përgjithësi, nga shqyrtimi i dosjeve të studentëve pranë sekretarisë mësimore, dokumentacioni na rezultoi i plotë dhe në zbatim me ligjin dhe kriteret e pranimit të studentëve. Megjithatë, konstatuam edhe raste studentësh të cilët kishin mbaruar ciklin e parë të studimeve jo në profile të përafërta.</p> <p>Nuk kishin kriteret specifike përfshirë numrin minimal dhe maksimal dhe mesataren përkatëse për pranimin e studentëve në këtë program studimi. Megjithatë institucioni rivlerëson kriteret dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit .</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Zyra e Karrierës është njësi e cila ndjek studentin në të gjitha hapat e tij, nga regjistrimi dhe deri në momentin e punësimit të tij. Kjo zyrë është përgjegjëse për sigurimin e mbarëvajtjes së procesit të zhvillimit të praktikave si dhe të këshillimit të karrierës; ndjek dhe organizon çështjet e karrierës të studentëve në UET; ofron këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve; bashkëpunon ngushtë me Departamentet e Fakulteteve për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve; mban komunikim me Bordet e Tregut të Punës për të tërhequr mendime mbi përputhjen e diplomave të ofruara me</p>

	<p>tregun e punës, si dhe për të lehtësuar procesin e praktikave</p> <p>Nga biseda që patëm me studentët, na u bë me dije se studentët informohen për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij, edhe nga Koordinator i Departamentit apo nga zyra e Këshillimit Studentor. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës përgjatë vit që zgjat programi i studimeve. Megjithatë studentët e kanë të vështirë mundësinë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatuam se UET disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e dytë programi Master Profesional në Shkenca Politike me profile.</p> <p>Numri total i studentëve të diplomuar ndër vite në këtë program studimi rezulton si më poshtë:</p> <p>2014-2015 rezultojnë 3 studentë; 2015-2016 rezultojnë 2 studentë; 2016-2017 rezultojnë 3 studentë;</p> <p>Numri i studentëve paraqet problematikë të vazhdueshme me një numër të ulët studentësh të regjistruar, por Universiteti ka akorduar bursa studentët e programit Master Profesional në Shkenca Politike dhe konkretisht 2 bursa studimi për vitin akademik 2016-2017 dhe 4 bursa studimi për vitin 2017-2018.</p> <p>Sekretaria mësimore, disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të programi të studimit.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Gjatë takimit me koordinatoren e zyrës së Karrierës, na u bë me dije se UET u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor.</p> <p>Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata zhvillojnë praktikën profesionale. Studentët e gjejnë vet institucionin ku do të kryejnë praktikën dhe pjesa më e madhe e studentëve të cilët janë në marrëdhënie pune e kryejnë aty praktikën.</p> <p>Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programit të studimit si dhe të atyre që vazhdojnë më tej ciklet e tjera të studimeve.</p>
--	---

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit dhe në vijimësi. Informacioni ndodhet në faqen e internetit të universitetit, u dërgohet elektronikisht përmes adresave elektronike, si edhe shpallen në tabelat e njoftimeve dhe prej dy vitesh është duke u përdorur sistemi LMS në lidhje me njoftimet për procesin mësimor (sylabuset, detyrat e kursit, provimet, oraret) dhe informacione të tjera.</p> <p>Gjithashtu institucioni përdor si metoda vlerësimi; dëgjimet në auditor, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, provime për module dhe praktikë, si dhe ese dhe prezantime individuale dhe në grup. Kriteret vlerësuese janë pjesëmarrja në leksion, eseja dhe provimi i ndërmjetëm dhe ai përfundimtar. Secili nga këta komponentë ka një peshë të shprehur në përqindjet korresponduese për vlerësimin përgjithshëm.</p> <p>Pas secilës detyrë apo provim, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar cdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Në rastet kur studenti pretendon për mos vlerësim korrekt ngrihet një komision i cili shqyrtonte rastin dhe mbante një procesverbal të cilin ia kalonte shefit të departamentit dhe pedagogut të lëndës. Pas kësaj seance pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve.</p>
---	--

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj

studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Kujdesit ndaj Studentit ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik.</p> <p>Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Kjo zyrë ka krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Pranimi i studentëve në programin e ciklin e dytë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit. Gjithashtu studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit. UET ka të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve nga pranimi deri në diplomim, gjithashtu ai disponon statistika për numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi dhe numrin e studentëve të punësuar pas diplomimit ose që vazhdojnë studimet e mëtejshme. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës përgjatë viteve që zgjat programi i studimeve dhe ndjek progresin e tyre.</p> <p>Megjithatë, konstatojmë se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është i kufizuar, dhe shpesh institucioni ofron bursa për të tërhequr studentë në këtë program studimi, prandaj rekomandojmë që departamenti duhet ta adresojë me prioritet këtë çështje për të garantuar një numër të qëndrueshëm studentësh, përfshi edhe politikën e bursave.</p> <p>Standardet janë plotësuar kryesisht</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

UET ka një strategji për Kërkimin Shkencor të azhurnuar (2017-2020) si dhe një pozicion të dedikuar posacërisht Kërkimit Shkencor, që është posti i Zv/Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë.



Politikat e kërkimit shkencor konsistojnë në mbështetje financiare për kërkimin shkencor si pjesë kontraktuale e pedagogut, dhe UET aplikon sistemin e granteve kërkimore për stafin akademik të cilat vlerësohen nëpërmjet 'Indikatorëve të Matjes së Performancës Kërkimore – Shkencore'. UET boton revistën shkencore 'Polis', revistë e specializuar që i shërben nevojave për publikime të mirëfillta të stafit akademik dhe doktorantëve në fushën e shkencave humane dhe shoqërore, zhvillon konferencën shkencore ndërkombëtare të përvitshme 'Ditët e Studimeve Shqiptare', organizon Ditët Doktorale dhe Ditë Informativë për grante kërkimore në nivel Evropian. Anëtarë të stafit akademik kanë fituar bursa kërkimi në universitete evropiane dhe institucioni ka qënë i suksesshëm në përfshirjen në projekte kërkimore të Komisionit Evropian.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

UET dhe Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara pas vitit 2013 ka arritur të marrë pjesë në projekte kërkimore dhe zhvillimore të cilat ia risin aktivitetin kërkimor institucionit dhe ndihmojnë në angazhimin praktik të studentëve. Konstatojmë se UET tregon një rritje përsa i përket treguesve të kërkimit shkencor, nëse i referohemi numrit të botimeve të personelit akademik, numrit të aktiviteteve shkencore të organizuara nga institucioni, numrit të pjesëmarrësve në aktivitete shkencore përfshi edhe studentët. Por ka një rënie përsa i përket numrit të projekteve të fituara dhe atyre të zbatuara që nga 2015 e deri më sot.

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

456 për vitet 2014-2017

- Numri i projekteve kërkimore të fituara dhe zbatuara për vitet 2015-2018

11 dhe 20 për vitet 2015-2018

- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

13

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

270 per vitet 2015-2017

- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

N/A

- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

17 per vitet 2015-2017

- Numri i Çmimeve Kombëtare

N/A

Numri i projekteve kërkimore të fituara dhe zbatuara ka qënë i konsiderueshëm me rreth 20, si dhe rreth 13 aktivitete të ndryshme shkencore të organizuara nga IAL ndërkohë që numri i pjesëmarrësve në to llogaritet në rreth 270 referenca. Por nga ana tjetër mungojnë referencat e kërkimit shkencor të përfshira në procesin mësimor.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Lista e projekteve në rang Departamenti dhe programi studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik botohen rregullisht në revistat akademike dhe shtëpinë botuese të institucionit. Kryesisht Polis, e cila është një revistë e specializuar që i shërben nevojave për publikime të mirëfillta stafit akademik dhe doktorantëve në fushën e shkencave politike. Personeli akademik i programit të studimit ka botuar në UET Press monografi ose kanë përkthyer autorë të huaj të cilat janë pjesë e literaturës së programit të studimit në shkencë politike.</p> <p>Gjithashtu, stafi akademik i angazhuar në projekte evropian (p.sh Jean Monnet Chair, Projekti Tempus për të Drejtat e Njeriut në arsimin e lartë) kontribuojnë me artikujt mbi çështje të caktuara dhe zhvillojnë kërkime për rikonceptualizimin dhe azhurnimin e kurrikulave mësimore dhe pasurimin e infrastrukturës mësimore me dije bashkëkohore. Ky është një kontribut direkt i personelit akademik në zhvillimin e kërkimit shkencor. Gjithashtu, personeli akademik merr pjesë në konferenca shkencore brenda dhe jashtë universitetit, dhe prodhon raporte në formën e policy-paper me rekomandimi me politikëbërjen dhe qeverisjen.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>UET përmes programit Erasmus+ ka angazhuar 9 pedagogë të departamentit, të cilët kanë dhënë 1 javë mësim në anglisht në një universitet të BE-së. Gjithashtu, pjesë e stafit akademik është angazhuar në mësimdhënie në gjuhë të huaj me studentët Erasmus+ që i ka pritur institucioni.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë pasi ose ka kryer studimet në atë gjuhë ose ka dëshmi të njohjes së avancuar.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>UET organizon në mënyrë periodike Staff Development Day – Ditën e Zhvillimit të Stafit, me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet, metodologjinë dhe TIK. Gjithashtu, anëtarët e stafit akademik kanë marrë pjesë në programe të ndryshme evropiane (p.sh në Programin European për Shkencë dhe Teknologji COST) ose trajnime të tjera më specifike për metodologjinë në kërkimin shkencor në shkencat sociale (p.sh Programi i Promovimit të Kërkimit Rajonal – RRPP).</p> <p>Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit është e angazhuar për të përfshirë stafin akademik në projekte kërkimore të lancuara nën programin FP7, në Konsortiume me partnerë ndërkombëtarë duke përgatitur dhe shpërndarë informacion në lidhje me mundësi aplikimi për programe kërkimore, trajnime dhe kualifikime si dhe duke ofruar konsulencë për zhvillimin e aplikimeve.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe visitat në institucion konstatohet se institucioni ka një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit si botimeve dhe pjesëmarrjeve me kumtese në konferenca brenda dhe jashtë vendit. Kopje të këtyre punimeve gjenden në bibliotekë si dhe dëshmi të dhënash në dosjen personale të stafit pranë burimeve njëzëzore.</p> <p>Gjithashtu, Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET disponon një bazë të dhënash (Excel spreadsheet) me detaje të projekteve kërkimore, zhvillimore, apo ndërtim-kapacitetesh në të cilat ka marrë pjesë ose është aktualisht i përfshirë personeli akademik, si dhe me detaje të projekteve në aplikim/të ardhshme me detaje për projektin; për donatorin; për partnerët; dhe për personelin akademik të përfshirë në të.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Personeli akademik botohen rregullisht në revistat akademike (Polis) dhe shtëpinë botuese të institucionit UET Press. Gjithashtu, stafi akademik i angazhuar në projekte evropiane (p.sh Jean Monnet Chair, Projekti Tempus për të Drejtat e Njeriut në arsimin e lartë) kontribuojnë në ri-konceptualizimin dhe azhurnimin e kurrikulave mësimore me dije bashkëkohore. Personeli akademik merr pjesë gjithashtu në konferenca shkencore dhe prodhon raporte në formën e policy-paper me rekomandime për çështje të caktuara të shoqërisë. UET përmes programit Erasmus+ ka angazhuar pedagogë të programit të cilët kanë dhënë 1 javë mësim në anglisht në universitete të BE-së. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij, nëpërmjet organizimit periodike të Ditëve të Zhvillimit të Stafit (trajnim në fusha të</p>	

lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet, metodologjinë dhe TIK), pjesëmarrjes në programe të ndryshme evropiane (p.sh COST, RRPP). Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit ofron informacion, trajnime dhe konsulencë për të përfshirjen e stafit akademik në projekte kërkimore evropiane. Institucioni mban një bazë të dhënash të hollësishme në lidhje me angazhimin e stafit në veprimtari kërkimore-shkencore.

Standardet janë plotësuar

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Bashkëpunimet ndërkombëtare të UET konsistojnë në memorandume bashkëpunimi me disa universitete lokale dhe ndërkombëtare, kryesisht në kuadër të programeve Tempus, Jean Monnet, Erasmus+ si dhe në kuadër të programeve mbështetëse për kërkimin nga donatorë ndërkombëtar dhe lokal si RRPP, NUFFIC, USAID, OSFA, AADF, Swiss Development Cooperation, Agjencitë e UN, etj. Disa nga këto bashkëpunime kanë në synim mobilitetin e stafi dhe studentëve përmes bursave Erasmus+. UET gjithashtu është fokusuar në ndërlidhjen e programeve të studimit me tregun e punës dhe komunitetin e biznesit, duke ngritur Bordet e Punës pranë secilit departament, organizimin e përvitshëm të një Panairi Pune me pjesëmarrje të punëdhënësve, ndërtimin e rrjetit UET Alumni. Megjithatë, Universiteti nuk disponon marrëveshje (memorandume) mirëkuptimi me institucione publike apo private për kryerjen e praktikave mësimore sidomos për përfshirje e studentët e ciklit të dytë Master Profesional në Shkenca Politike.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare **13**
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj **37**
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit **30 (erasmus + staf akademik)**
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
 - 13 student kanë ardhë në UET përmes bursave Erasmus +**
 - 38 student nga UET kanë përfituar bursa Erasmus +**
 - 19 student të UET kanë lëvizur përmes programeve të tjera të BE (SIGMA) dhe programeve bilaterale**
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
 - Biblioteka, Abonimi në EBSCO, SAGE online si edhe të tjera burime online;**
 - Laborator IT; infrastrukturë anti-plagjarizëm; Salla konferencash dixhitale;
 - trajnimi i brendshëm i stafit akademik: Kërkimi me Impakt; Si të komunikojmë Shkencën; UET Research group; Si të aplikojmë për projekte; etj. Ditët Doktorale; Revistat Shkencore (Economicus dhe Polis); Ditë Informative për

grante kërkimore në nivel European (AKTI, RCE, etj.); Ditët e Studimeve Shqiptare. Ka vend për përmirësim, vëncarisht në drejtim të përfshirjes së më shumë database të kërkimit shkencorë që garantojnë aksesin në revista shkencore të specializuara si dhe financim të konferencave shkencore në vendet e OECD-së për stafin akademik të programit të shkencave politiko-administrative.

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime **21 (erasmus + staf administrativ)**
- Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor **1**

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

UET ka një bashkëpunim të mirë me komunitetin e biznesit dhe si praktikë Zyra e Karrierës dhe Praktikave. Megjithatë, për programin e studimeve në shkencë politike shpeshherë vetë studentët e sigurojnë institucionin ku kryejnë praktikë pasi shumica e tyre janë në marrëdhënie pune. Gjithsesi, universiteti nuk disponon marrëveshje (memorandume) mirëkuptimi me institucione publike apo private adapte dhe në funksion të programit të studimit Master Profesional në Shkencë Politike.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Praktikant në institucion të studenteve Master

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>UET ka fokus bashkëpunimin dhe ndërlidhjen e programeve të studimit me tregun e punës dhe komunitetin e biznesit, duke ndërmarrë një numër iniciativash si Bordet e Punës pranë secilit departament, organizimin e përvitshëm të një Panairi Pune me pjesëmarrje të punëdhënësve, ndërtimin e rrjetit UET Alumni, Programi 250+ nëpërmjet të cilit studentëve u ofrohen mundësi të ndjekjes së praktikave në biznese dhe kompani të llojeve të ndryshme, bashkëpunime me sektorin privat përmes UET Enterprise nëpërmjet konsulencës për të tretët.</p> <p>Si praktikë, Zyra e Karrierës dhe Praktikave ndihmon studentin në kryerjen e praktikave profesionale. Megjithatë, konstatohet se për programin e studimeve në shkencë politike shpeshherë studentët e sigurojnë vetë institucionin ku kryejnë praktikë pasi shumica e tyre janë në marrëdhënie pune.</p>

Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;

Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

Nga vizita në terren konstatojmë se ka një ndarje të mirë të detyrave si brenda departamentit, ashtu dhe midis zyrave të ndryshme administrative. Ndarja e detyrave në lidhje me procesin mësimor dhe mbarëvajtjen e zhvillimit të programit të studimit është e përcaktuar në aktet rregullatore të institucionit, të cilat janë të publikuara në dokumentet UET dhe zbatimi i tyre monitorohet vazhdimisht.

Praktikat e mira që vumë re ishte funksionimi i pavarur i Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për mbarëvajtjen e jetës studentore që merret dhe me organizimin e Open Day dhe përgatit Manualin e Studentit, si dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit që ndjek karrierën e studentëve.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtijshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

UET ka marrëveshje dhe bashkëpunime me Universitete të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare në kuadër të programeve evropiane për ngritjen e kapaciteteve dhe për shkëmbimet e studentëve dhe profesorit, pjesë përfituese e të cilava është edhe stafi dhe studentët e programit të studimit master profesional në shkencë politike.

UET organizon trajnime profesionale sic është lënda praktikë dhe zhvillim karriere e detyrueshme për të gjithë studentët master, në këto takime angazhohen lektorë të ftuar sikurse dhe ekspertë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Universiteti pavarësisht marrëveshjeve me bizneset dhe iniciativat e tjera, resulton se nuk ka marrëveshje specifike me institucione të përshtatshme për kryerjen cilësore të praktikës mësimore të studentëve të programit të studimit master profesional në shkencë politike. Nga diskutimet me studentët konstatojmë se një pjesë e mirë e studentëve sidomos ata të cilët janë në marrëdhënie pune e kryejnë praktikën profesionale pranë institucionit ku ata punojnë.

Institucioni analizon ecurinë dhe rezultatet e bashkëpunimeve me qëllim identifikimin e mënyrave dhe mjeteve për të rritur cilësinë dhe impaktin e këtij bashkëpunimi, por kjo analizë gjithsesi qëndron në nivel institucional dhe jo për program studimi.

Konkluzionet e vlerësimit: Ndarja e detyrave si brenda departamentit ashtu dhe mes zyrave të ndryshme administrative në lidhje me procesin mësimor dhe mbarëvajtjen e zhvillimit të programit të studimit është e përcaktuar në aktet rregullatore të institucionit. Universiteti për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin midis personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit. UET ka marrëveshje dhe bashkëpunime

me Universitete të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare në kuadër të programeve evropiane për ngritjen e kapaciteteve dhe për shkëmbimet e studentëve dhe profesorit, pjesë përfutuese e të cilava është edhe stafi dhe studentët e programit të studimit master profesional në shkencat politike. UET gjithashtu ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit dhe iniciativa të cilat ndërlidhin programeve të studimit me tregun e punës (Bordet e Punës, Panairi i Punës, rrjeti UET Alumni, Programi 250+) si dhe organizon trajnime profesionale me lektorë dhe ekspertë të ftuar nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Institucioni analizon ecurinë dhe rezultatet e bashkëpunimeve me qëllim identifikimin e mënyrave dhe mjeteve për të rritur cilësinë dhe impaktin e këtij bashkëpunimi, por kjo analizë gjithësesi qëndron në nivel institucional dhe jo për program studimi. **Konstatojmë** gjithashtu se pavarësisht marrëveshjeve me bizneset dhe iniciativat e tjera, rezultojnë se nuk ka marrëveshje specifike me institucione të përshtatshme për kryerjen cilësore të praktikës mësimore të studentëve të programit të studimit master profesional në shkencat politike. Prandaj për shkak të specifikës së programit të studimit, pavarësisht iniciativat të bashkëpunimit me sektorin e biznesit **rekomandohet** që universiteti të krijojë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo private adapte dhe në funksion të programit të studimit Master Profesional në Shkencat Politike.

Standardet janë plotësuar kryesisht

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E PORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITE, THREATS-PENGESAT).

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se rekomandimet e lëna nga akreditimi i parë janë përbushur plotësisht në masën më të madhe, dhe vetëm disa rekomandime janë plotësuar kryesisht.

Institucioni ka ndjekur politika efikase dhe realiste në funksion të forcimit të strukturave kontrolluese për rritjen e efektivitetit në fushën e kërkimit shkencor, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen cilësore por edhe sasiore të aktiviteteve të lidhura me kërkimin shkencor. Vendosja e sistemit të granteve, përdorimi i Indikatorëve të Matjes së Performancës Kërkimore – Shkencore, botimi i revistave në gjuhën angleze, krijimi i traditës së organizimit të konferencave shkencore ndërkombëtare, sikurse dhe politikat e tjera, shërbejnë në mbështetjen dhe nxitjen e kërkimit shkencor. Përgjithësisht mendojmë se mbështetja dhe nxitja për veprimtarinë kërkimore — shkencore të personelit akademik ka ndikuar në rritjen e shkallës së kualifikimit të personelit akademik. Krijimi i grupeve kërkimore, të cilat udhëhiqen nga pedagogë të kategorisë Profesor, vlerësohet si një mënyrë efikase e organizimit e cila ndikon jo vetëm në kërkimin shkencor por edhe në profilizimin e personelit akademik. Lidhjet e vendosura me tregun e punës sikurse dhe përfshirja e ekspertëve të jashtëm në një sërë veprimtarish në institucion, vlerësohen si pozitive, në funksion të përshtatjes së programeve të studimeve me kërkesat e tregut të punës, por edhe me impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e shkallës së punësimit të

studentëve si gjatë studimeve ashtu edhe pas diplomimit. Përdorimi i teksteve bazë të botuara nga shtëpitë botuese prestigjioze ndërkombëtare, ndërthurja e tyre me material në gjuhën shqipe, sikurse dhe facilitetet e krijuara nga biblioteka si me literaturën në hard copy ashtu dhe me aksesin në libraritë online, vlerësohen si pozitive nga GVJ. Bashkëpunimi me aktorë vendas apo të huaj, nga sektori publik dhe/ose privat, pjesëmarrja në një sërë projektsh kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, janë tregues cilësor të veprimtarisë së UET.

Megjithatë, disa çështje pavarësisht se janë adresuar nga institucioni, vlerësojmë se ka ende hapësirë për tu riparë me qëllim përmirësimin e tyre.

Plani mësimor aktual është rishikuar në masën e 3 lëndëve, përfshi edhe uljen e krediteve për praktikën profesionale, si dhe adaptimin në program studimi me 60 ECTS dhe 1 vit akademik. Realizimi i programit të studimit (orë në auditor) bëhet pasdite e mërkurë-e premte dhe ditëve të shtuna pothuajse gjithë ditën, në një shpërndarje mësimdhënieje jo uniforme në kohë gjatë javës. Tarifa e studimeve nuk ka pësuar ulje, por në disa raste institucioni ka ofruar bursa studimi për të rritur interesimin e kontigjenteve më cilësore, Gjithashtu, **konstatojmë se:**

- 1) numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është i kufizuar, dhe shpesh institucioni ofron bursa për të tërhequr studentë në këtë program studimi, **prandaj rekomandohet** që departamenti ta adresojë me prioritet këtë çështje dhe të shtojë përpjekjet për të siguruar numrin e nevojshëm të studentëve, përfshi edhe politikën e bursave, për të garantuar një një qëndrueshmëri financiare më të sigurt në zhvillimin e këtij programi studimi
- 2) pavarësisht iniciativa të bashkëpunimit me sektorin e biznesit, studentët në marrëdhënie punë kryejnë praktikën profesionale në institucionin ku ata punojnë, gjë që shpesh herë mund të mos jetë në funksion të programit të studimit, **prandaj për shkak të specifikës së programit të studimit rekomandohet** që departamenti të krijojë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo private adapte dhe në funksion të programit të studimit Master Profesional në Shkenca Politike.

Pika të forta:

- 1) Programi synon aftësimin e studentëve në analizën e fenomeneve, ngjarjeve, koncepteve, ligjeve, politikave apo dukurive të tjera që hasen në zhvillimet e sotme në plan kombëtar e ndërkombëtar, si dhe t'i operacionalizojë dhe aplikojë në praktikë konceptet teorike të lëndëve.
- 2) Programi i studimit pasqyron vullnetin e institucionit për të ruajtur disiplina si ajo e shkencave politike, dhe zhvilluar më tej ekzpertizën në çështje të sjelljes politike dhe politikave publike. Programi i studimit është në përputhje me interesat dhe synimet strategjike të zhvillimit politiko-ekonomik të vendit. Gjithashtu, në hartimin e këtij programi janë marrë në konsideratë zhvillimet politike të demokratizimit të vendit nëpërmjet trajtimit të tematikave dhe rasteve të studimit nga vendi, të cilat janë të përbrendësuara në shumicë e lëndëve të këtij programi dhe reflektojnë një qasje kulturore kombëtare.
- 3) Konsiderojmë një praktikë pozitive mbajtjen e rregullt të leksioneve të hapura.
- 4) Veprimtaria akademike dhe ajo administrative në UET bazohet në rregulla të qarta e të sakta, të shprehura në Statutin e UET, Rregulloren Bazë të UET, Broshurën e Dokumenteve Themelore të UET, etj. Këto dokumente, janë të depozituara në sistemin

informatik të UET dhe të disponueshme elektronikisht nga tërë personeli akademik, administrativ si dhe studentët për çështje në interes të tyre.

- 5) Rekrutimi dhe cilësia e stafit është një element tjetër pozitiv që në këtë program studimi janë rekrutuar vençarisht nga burimet e brendshme, pra nga ish-doktorantë që kanë përfutur titullin Doktor në Institucion por ka dhe nga departamentet e tjera. Rekrutimi i personelit akademik mbështetet mbi eksperiencën në mësimdhënien universitare, grada/titulli shkencor i kandidatit për pedagog dhe aktiviteti kërkimor shkencor e botues i tij.
- 6) Qëndrueshmëria e personelit efektiv akademik, rreth 93% e personelit efektiv të institucionit është i angazhuar prej dy ose më shumë vitesh në aktivitetin akademik të UET. Ky është një indikator i rëndësishëm që tregon se stafi i tanishëm i UET është më i përkushtuar ka mundësi t'i qëndrojë më afër studentit.
- 7) Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa indikatorëve, me synim vlerësimin e vazhdueshëm për ta vendosur studentin në punë përgjatë të gjithë vitit. Vlerësimi i vazhdueshëm nxit nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit dhe ka natyrë stimuluese e inkurajuese.
